



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-060/01-0041998/26 dt. 20.07.2026

Mitrovicë

Në zbatim të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale; nenit 11, të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë, nenit 62, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; nenit 15, pika 2, të Rregullores Komunale për punën e komiteteve të Kuvendit të Komunës; Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për të **martën** më dt. **28.07.2026**:

T H Ë R R E T

Mbledhjen e rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa (Mbledhja e 7-të)

Mbledhja do të ketë këtë REND DITE:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Draft-Rregullore për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2023 Për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve dhe hapësirave publike
3. Propozim-vendim për organizimin e konkursit komunal dhe ndarjen e çmimeve për kopshtin, ballkonin, sipërfaqen më të mirë të rregulluar para lokaleve afariste dhe atyre të gastronomisë
4. Propozim-vendim për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € të z. Sabri Çabra
5. Propozim-vendim për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € të OJQ “REC” – Mitrovicë
6. Propozim-vendim për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € të OJQ “OPFAKOS” – Mitrovicë
7. Propozim-vendim për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € të OJQ “SË BASHKU” – Mitrovicë
8. Propozim-vendim për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € të OJQ “Zëri i Prindërve” – Mitrovicë

9. Propozim-vendim për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € të OJQ “HANDIKOS” – Mitrovicë
10. Propozim-vendim për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € për Shoqatën “Minatori ’89”
11. Propozim-vendim për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € për Shoqatën e të Verbërve në Mitrovicë
12. Propozim-vendim për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € për Shoqatën e të Shurdhërve në Mitrovicë
13. Propozim-vendim për mbështetje financiare në shumën prej 250.00 € në muaj për tetë (8) familje nga Bajri
14. Propozim-vendim për mbështetje financiare në shumën prej 250.00 € për viktimat e dhunës gjatë vitit 2026 në Komunën e Mitrovicës së Jugut
15. Propozim-vendim për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € për mbulimin e qirasë për Qendrën për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve “Raba Voca” në Mitrovicë
16. Propozim-vendim për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € për ofrimin e shërbimeve sociale dhe rehabilituese të OJQ-s “Down Syndrome Kosova” – Dega në Mitrovicë
17. Raport gjashtëmujor i punës së Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritet Evropian (janar-qershor 2026)

Mbledhja do të mbahet në Sallën e Mediave duke filluar nga ora 10:00.

Mitrovicë





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02-060/01-0034897-1/26 dt. 26.06.2026

Mitrovicë

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa
Mbledhja e 6-të

Koha: 26.06.2026 ora 10:00

Vendi: Salla e Mediave

Të pranishëm: Kryesuesi i Kuvendit z. Safet Kamberi

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Majlinda Kurti, Igballe Islami,
Valon Brahimi, Erseka Barani, Kushtrim Zeneli dhe Visar Syla

Nënkryetari i komunës z. Enis Osmani,

Anëtarët e Bordit të Drejtorëve

Mungoi:

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Safet Kamberi i cili theksoi se në zbatim të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale; nenit 11, të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteve të përhershme dhe komiteve tjera në Komunë, nenit 62, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; nenit 15, pika 2, të Rregullores Komunale për punën e komiteve të Kuvendit të Komunës, për sot kam thirrur mbledhjen e pestë të Komitetit për Politikë dhe Financa me rendin e ditës të paraparë me thirrje.

Në vazhdim Kryesuesi hapi diskutimin lidhur me rendin e ditës.

Gazmend Gjoshaj: Propozoj që të hyjë si pikë Kërkesa për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara në vitin 2025 dhe vitet paraprake në vitin 2026.

Valon Brahimi: Rikujtoi se ishim dakorduar që Drejtoria e Arsimit të paraqesë një raport të detajuar lidhur me mungesën e mësimdhënësve në institucionet arsimore. Gjithashtu, kërkoj sqarime lidhur me organizimin e vizitës së nxënësve në kampin në veri, përfshirë arsyet dhe mënyrën e realizimit të këtij aktiviteti.

Kryesuesi hedh në votim që të hyjë si pikë e 10-të Kërkesa për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara në vitin 2025 dhe vitet paraprake në vitin 2026.

Rezultati i votimit: 6-për, 0-kundër, 0-abstenime.

Kryesuesi konstaton se u miratua unanimisht që si pikë të hyjë Kërkesa për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara në vitin 2025 dhe vitet paraprake në vitin 2026, po ashtu konstaton se të pranishëm në sall janë 6 anëtarë.

Në vazhdim Kryesuesi vuri në votim rendin e ditës të plotësuar si në vijim:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Korniza Afatmesme Buxhetore 2027/2029
3. Propozim Vendim Për caktimin e Parcelës komunale për Ndërtimin e fushave të tenisit dhe të fushave të padelit
4. Rregullimi dhe harmonizimi i numrit të stafit në kuadër të Organizatës Buxhetore
5. Raporte të komisionit për vlerësim të dëmeve në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera
6. Raporti vjetor i menaxhimit të mbeturinave Komunale për vitin 2025
7. Raportet në Lëmin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
8. Informatë për gjendjen në Shëndetësi
9. Informatë e Planifikimit dhe realizimi i mbjelljeve pranverore për vitin 2026
10. Kërkesa për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara në vitin 2025 dhe vitet paraprake në vitin 2026

Rendi i ditës u miratua unanimit (6 për, 0 kundër dhe 0 abstenime).

Pika 1

Procesverbali nga mbledhja e pestë e KPF-së u miratua unanimit (6 për, 0 kundër dhe 0 abstenime).

Pika 2

Kryesuesi z. Safet Kamberi para se të hapë diskutimin lidhur me Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027/2029. , për ta arsyetuar të njëjtën fjalën ia kaloi Drejtorit të DBF-së z. Gazmend Gjoshaj.

Pas arsyetimit të pikës nga Drejtori i DBF-së z. Gazmend Gjoshaj, Kryesuesi i mbledhjes hapi diskutimin.

Igballe Islami: Kërkoj që qarkorja buxhetore t'u bashkëngjitet materialeve të mbledhjes së Kuvendit, në mënyrë që anëtarët të kenë mundësi ta shqyrtojnë paraprakisht dhe të jenë më të informuar gjatë diskutimit dhe vendimmarrjes.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesi vuri në votim Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027/2029.

Rezultati i votimit: 6-për, 0-kundër, 0-abstenime.

Korniza Afatmesme Buxhetore 2027/2029 u miratua dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 3

Kryesuesi i mbledhjes Safet Kamberi hapi diskutimin lidhur me Propozim Vendimin Për caktimin e Parcelës komunale për Ndërtimin e fushave të tenisit dhe të fushave të padelit.

Udhëheqësi i Sekretarisë z. Nazmi Jashari dha sqarimin ligjor.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesi vuri në votim Propozim Vendimin Për caktimin e Parcelës komunale për Ndërtimin e fushave të tenisit dhe të fushave të padelit.

Rezultati i votimit: 6 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Propozim Vendimi Për caktimin e Parcelës komunale për Ndërtimin e fushave të tenisit dhe të fushave të padelit u miratua dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 4

Kryesuesi i mbledhjes Safet Kamberi hapi diskutimin lidhur me Propozimin për Rregullimin dhe harmonizimin e numrit të stafit në kuadër të Organizatës Buxhetore.

Nënkryetari i komunës z. Enis Osmani: Duhet t'i përgjigjem z. Brahimi sa i përket çështjes së vilës së Radojçiq lidhur me pretendimet për vizitat e nxënësve në këtë objekt, duke u theksuar se objekti që nga viti 2023 nuk është në pronësi të Radojçiqit, por objekti është në shfrytëzim të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe se vizitat e nxënësve të shkollave nga e gjithë Kosova janë realizuar në kuadër të aktiviteteve/ekskursioneve edukative në vilën e Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave (AME), dhe jo në një pronë private siç është pretenduar.

Igballe Islami Paraqiti vërejtje lidhur me propozim-vendimin, duke kërkuar që materiali të plotësohet me një arsyetim më të detajuar sa i përket kërkesës së Drejtorisë së Arsimit. Ajo kërkoj gjithashtu të sqarohet baza ligjore mbi të cilën mbështetet bartja e pozitave, përkatësisht ligji apo rregullorja përkatëse që e mundëson një veprim të tillë. Gjithashtu, ajo kërkoj sqarime nga aspekti financiar, konkretisht nëse me këtë bartje do të transferohen vetëm pozitat e punës apo do të bartet edhe buxheti i ndarë për këto pozita.

Nënkryetari i komunës z. Enis Osmani: Në përgjigje të vërejtjeve të paraqitura, sqaroi se me këtë propozim-vendim nuk parashihet krijimi i vendeve të reja të punës. U theksua se bëhet fjalë për bartjen e pozitave ekzistuese, të cilat janë të buxhetuara nga drejtoritë përkatëse, në Drejtorinë e Arsimit. Po ashtu, sqaroi se mjetet financiare për pagat e këtyre pozitave tashmë janë të planifikuara në buxhet dhe se për këtë proces nuk kërkohen mjete shtesë buxhetore.

Valon Brahimi: Ngris shqetësime lidhur me propozim-vendimin për bartjen e pozitave dhe të hyrave buxhetore në Drejtorinë e Arsimit. Ai kërkoj sqarime për mënyrën se si do të realizohet bartja e të hyrave buxhetore, duke theksuar se, sipas vlerësimit të tij, në administratën komunale nuk ka pozita të mësimdhënësve, si profesorë apo arsimtarë, dhe se nuk është e qartë se cilat pozita do të barten në Drejtorinë e Arsimit. Më tej, ai vlerësoi se shkresa përcjellëse nuk është mjaftueshëm e qartë dhe nuk përmban arsyetim të plotë mbi mënyrën e realizimit të këtij procesi, ndonëse theksoi se e kupton nevojën për një organizim të tillë. Gjithashtu, duke iu referuar Ligjit për Zyrtarët Publikë, ai theksoi se ligji përcakton kategori të ndryshme të nëpunësve dhe ngriti dilemë nëse është e lejuar që pozitat nga kategori të ndryshme të nëpunësve të barten dhe të buxhetohen në kuadër të Drejtorisë së Arsimit. Për këtë çështje, ai kërkoj sqarim mbi bazën ligjore që e mundëson një veprim të tillë.

Nënkryetari i Komunës z. Enis Osmani në përgjigje të diskutimit, theksoi se përmirësimi i gjendjes në arsim mbetet një nga prioritetet e qeverisjes komunale. Ai bëri të ditur se sektori i arsimit përballlet me sfida të shumta, duke përmendur se vetëm gjatë vitit të kaluar janë regjistruar mbi 20.000 orë të humbura mësimore. Sipas tij, edhe gjatë mandatit aktual ka raste të orëve të humbura, por këto probleme nuk mund të zgjidhen menjëherë. Më tej, ai theksoi se në Drejtorinë e Arsimit ekzistojnë edhe kontrata me afat të caktuar, gjë që, sipas tij, dëshmon gjendjen e rënduar në këtë sektor. Lidhur me propozim-vendimin, sqaroi se bartja e pozitave është propozuar me qëllim të përmirësimit të organizimit dhe rritjes së cilësisë në arsim. Ai bëri të ditur se, para procedimit të këtij propozimi, është konsultuar Drejtoria kompetente së bashku me Zyrën Ligjore dhe se veprimi është mbështetur në bazën ligjore përkatëse, duke theksuar se komuna nuk do të ndërmerre një veprim të tillë pa u siguruar paraprakisht për bazën e tij ligjore.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesi vuri në votim Propozimin për Rregullimin dhe harmonizimin e numrit të stafit në kuadër të Organizatës Buxhetore.

Rezultati i votimit: 5 për, 1 kundër dhe 0 abstenime.

Rregullimi dhe harmonizimi i numrit të stafit në kuadër të Organizatës Buxhetore u miratua dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 5

Kryesuesi i mbledhjes Safet Kamberi hapi diskutimin lidhur me Raportet e komisionit për vlerësim të dëmeve ne rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera.

Valon Brahimi Kërkoj sqarim nga drejtoresha lidhur me deklarin e saj se gjatë qeverisjes së kaluar nuk ishte përgatitur raporti, duke pyetur nëse raporti ka ekzistuar apo jo.

Fitore Mehmeti Sqaroi se raporti ishte përgatitur, mirëpo nuk ishte proceduar për shqyrtim në Kuvendin Komunal.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesi vuri në votim Raportet e komisionit për vlerësim të dëmeve ne rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera që në kuvend të miratohen veç e veç.

Rezultati i votimit: 7 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Raportet e komisionit për vlerësim të dëmeve ne rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera u miratuan unanimit dhe i procedohen Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 6

Kryesuesi z. Safet Kamberi para se të hapë diskutimin lidhur me lidhur me Raportin vjetor të menaxhimit të mbeturinave Komunale për vitin 2025, për ta arsyetuar të njëjtën fjalën ia kaloi Drejtoreshës znj. Arjeta Beqiri.

Pas arsyetimit të pikës nga Drejtoresha znj. Arjeta Beqiri, Kryesuesi i mbledhjes hapi diskutimin.

Valon Brahimi kërkoi informata lidhur me numrin e deponive inerte në territorin e komunës, si dhe sqarime për lokacionet ku ato janë identifikuar.

Arjeta Beqiri: Sqaroi se, sipas raportit, fillimisht janë identifikuar 11 deponi ilegale, ndërsa 5–6 prej tyre janë larguar me mbështetjen e Ministrisë. Lidhur me mbeturinat inerte, bëri të ditur se ato kanë një lokacion të caktuar, ndërsa theksoi se komuna është në dijeni të mungesës së një deponie të dedikuar për mbeturina inerte. Në fund, rikujtoi se raporti në shqyrtim i referohet periudhës së qeverisjes së kaluar.

Pasi nuk kishte të tjerë të lajmëruar për diskutim, Kryesuesi vuri në votim Raportin vjetor të menaxhimit të mbeturinave Komunale për vitin 2025.

Rezultati i votimit: 7 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Raporti vjetor i menaxhimit të mbeturinave Komunale për vitin 2025 u miratua unanimit dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 7

Kryesuesi i mbledhjes Safet Kamberi hapi diskutimin lidhur me Raportet në Lëmin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Valon Brahimi: U ngrit çështja lidhur me organizimin e disa aktiviteteve gjatë periudhës së fushatës politike dhe u kërkua sqarim nëse këto aktivitete kanë pasur karakter kulturor apo kanë qenë të ndërlidhura me aktivitete politike. Po ashtu, u kërkua që aktivitetet e raportuara të jenë

të dokumentuara dhe të qarta për nga përmbajtja, mënyra e organizimit dhe përputhshmëria me kompetencat e institucioneve përkatëse.

Nënkryetari i Komunës z. Enis Osmani: Në përgjigje u sqarua se aktivitetet e realizuara nga qendrat dhe institucionet kulturore zhvillohen në kuadër të programit të tyre të punës dhe kanë për qëllim promovimin e kulturës, pavarësisht pjesëmarrjes së subjekteve apo individëve të ndryshëm. U theksua se institucionet kulturore duhet të mbeten të fokusuara në misionin e tyre dhe të mos përdoren për qëllime elektorale apo politike.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesi vuri në votim Raportet në Lëmin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Rezultati i votimit: 7 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Raportet në Lëmin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit u miratuan unanimisht dhe i procedohen Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 8

Kryesuesi i mbledhjes Safet Kamberi hapi diskutimin lidhur me Informatën për gjendjen në Shëndetësi.

Valon Brahimi Ngriti çështjen e aplikimit të pagesave për shërbimet shëndetësore, duke theksuar se ato prekin të gjithë qytetarët, pavarësisht gjendjes së tyre ekonomike. Ai pyeti nëse ekziston bazë ligjore për zbatimin e këtyre pagesave dhe nëse janë shqyrtuar mundësitë për lirim të kategorive të caktuara të qytetarëve.

Drejtoresha e Shëndetësisë Albina Kastrati Rama sqaroi se pagesat për shërbimet shëndetësore bazohen në Ligjin përkatës dhe në Udhëzimin Administrativ Nr. 03/2024 për bashkëpagesat në shërbimet shëndetësore. Ajo theksoi se institucionet shëndetësore janë të obliguara të zbatojnë këto dispozita ligjore dhe të inkasojnë pagesat e përcaktuara. Më tej, ajo bëri të ditur se një numër i konsiderueshëm i kategorive të qytetarëve janë të liruar nga bashkëpagesat, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Sipas saj, lirimet kanë ekzistuar vazhdimisht dhe zbatohen vetëm për kategoritë që i plotësojnë kushtet e përcaktuara me ligj, ndërsa në rastet e tjera pagesat realizohen në përputhje me dispozitat ligjore. Gjithashtu, ajo theksoi se të hyrat nga këto pagesa përbëjnë të hyra vetanake të institucionit shëndetësor dhe se institucioni ka obligim ligjor për mbledhjen e tyre.

Valon Brahimi Diskutoi lidhur me çështjen e pagesave dhe trajtimin e rasteve të qytetarëve, duke theksuar se për këto çështje duhet të ketë një qasje më të koordinuar dhe më të drejtë. Ai kërkoi sqarime lidhur me procedurat e ndjekura dhe mundësitë për mbështetje të rasteve të caktuara. Ai theksoi se çështjet e tilla nuk duhet të trajtohen vetëm nga aspekti administrativ, por edhe nga aspekti njerëzor, duke marrë parasysh rrethanat dhe nevojat e qytetarëve.

Drejtoresha e Drejtorisë së Shëndetësisë Albina Kastrati Rama sqaroi se për rastin konkret është ndërmarrë procedura përmes propozimit-vendimit të Drejtorisë së Shëndetësisë, i cili është proceduar për shqyrtim në Kuvend. Ajo bëri të ditur se është propozuar që të mbulohet një pjesë e shumës së kërkuar, duke theksuar se kjo çështje është trajtuar edhe në aspektin institucional. Ajo theksoi se institucionet duhet të respektojnë procedurat ligjore dhe financiare, pasi Drejtoria e Shëndetësisë është e lidhur me rregullat dhe kompetencat që përcaktohen nga institucionet përkatëse.

Nënkryetari i Komunës z. Enis Osmani: Sa i përket respektimit të orarit të punës nga punonjësit shëndetësorë, duke theksuar se kontratat e punës duhet të respektohen në mënyrë të barabartë nga të gjithë. Ai theksoi se orari i përcaktuar në kontratat e punës për mjekët dhe

infirmierët duhet të zbatohet dhe se nuk duhet të ketë dallime në respektimin e obligimeve ndërmjet sektorëve të ndryshëm publikë. Sipas tij, edhe punonjësit e administratës, bibliotekave dhe institucioneve të tjera komunale janë të obliguar të respektojnë orarin e punës, prandaj i njëjti standard duhet të vlejë edhe për sektorin e shëndetësisë. Ai shprehu shqetësimin për gjendjen në shëndetësi dhe kërkoi që çështjet e organizimit të punës, respektimit të orarit dhe përgjegjësiwe profesionale të trajtohen me seriozitet, duke paralajmëruar se këto çështje do të vazhdojnë të shqyrtohen edhe në takimet e ardhshme, pas përfundimit të diskutimit lidhur me raportin e shëndetësisë, theksoi se dëshiron të japë disa komente shtesë, duke kërkuar që diskutimi të zhvillohet në frymën e korrektësisë dhe respektit institucional. Ai ngriti çështjen e gjendjes së shërbimeve shëndetësore dhe mënyrës së menaxhimit të tyre, duke shprehur kritika për qeverisjet e kaluara dhe për mungesën e investimeve të mjaftueshme në këtë sektor. Ai theksoi se shëndetësia është një fushë me rëndësi të veçantë dhe se problemet e akumuluar ndër vite kërkojnë trajtim serioz dhe përgjegjësi institucionale. Po ashtu vlerësoi punën dhe angazhimin e disa zyrtarëve dhe punonjësve shëndetësorë, duke theksuar se individët të cilët punojnë me përkushtim duhet të mbështeten dhe të vlerësohen për kontributin e tyre. Ai theksoi se gjatë periudhave të ndryshme qeverisëse janë bërë investime të ndryshme në Komunën e Mitrovicës, por sipas tij, duhet të bëhet një analizë e qartë e investimeve kapitale të realizuara në sektorin e shëndetësisë.

Valon Brahimi: Ngriti shqetësimin lidhur me mungesën e mjekut në Kçiq, po ashtu unë jam i njoftuar që nuk ka mjek fare në Kçiq.

Albina Kastarti Rama: Theksoj se ishin mësuar që ta mos respektojnë orarin e punës në disa institucione shëndetësore. Ai theksoi se, sipas vlerësimit të tij, menaxhimi i pushimeve vjetore nuk është bërë në mënyrë të duhur, pasi një numër i madh i punonjësve i kanë shfrytëzuar pushimet në të njëjtën periudhë, gjë që ka ndikuar në ofrimin e shërbimeve për qytetarët. U sqarua se punonjësit kanë të drejtë ligjore për shfrytëzimin e pushimit vjetor dhe se, në rastin konkret, një pjesë e tyre i kanë shfrytëzuar pushimet në të njëjtën periudhë, pasi nuk i kishin përfunduar më herët. Gjithashtu, u theksua se institucioni nuk ka të drejtë t'ua mohojë punonjësve shfrytëzimin e pushimit vjetor që u takon sipas ligjit.

Erseka Barani: Duke iu përgjigjur diskutimeve, theksoi se gjatë qeverisjes së kaluar ishin planifikuar rreth 80.000 euro të hyra vetanake, ndërsa, sipas saj, nuk ishte arritur të realizoheshin as 60.000 euro. Ajo bëri të ditur se rregulloret në fuqi janë të trashëguara nga qeverisja e kaluar dhe se tarifat për shërbimet shëndetësore janë të përcaktuara me këto akte, duke shtuar se qytetarët kanë mundësi të paguajnë tarifa prej 1 deri në 3 euro për të përfituar shërbime në institucionet publike, në vend që t'i drejtohen sektorit privat. Më tej, theksoi se gjatë mandatit të saj janë realizuar projekte përmes donatorëve, falë të cilëve kanë filluar të ofrohen analiza laboratorike, përfshirë analizën e vitaminës D dhe analiza të tjera, të cilat në sektorin privat kanë kosto më të lartë. Sipas saj, këto shërbime më pas janë ndërprerë. Gjithashtu, përmendi investimet e realizuara në disa qendra të mjekësisë familjare, përfshirë ato në Bare dhe Bajgorë, duke shtuar se nuk është e nevojshme të ndalen në diskutime për zhvillimet e para rreth gjashtë viteve, pasi gjendja aktuale në sektorin e shëndetësisë mbetet sfiduese dhe kërkon angazhim të vazhdueshëm. Kështu që drejtoreshën e përgëzoj që po punon në të mirën e qytetarëve, se edhe ashtu ka shumë kategori që lirohen nga pagesat.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesi vuri në votim Informatën për gjendjen në Shëndetësi.

Rezultati i votimit: 4 për, 2 kundër dhe 1 abstenime.

Kryesuesi i mbledhjes konstatoi: Informata për gjendjen në Shëndetësi u miratua dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 9

Kryesuesi i mbledhjes Safet Kamberi hapi diskutimin lidhur me Informatën e Planifikimit dhe realizimi i mbjelljeve pranverore për vitin 2026.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim, Kryesuesi vuri në votim Informatën e Planifikimit dhe realizimi i mbjelljeve pranverore për vitin 2026.

Rezultati i votimit: 4 për, 1 kundër dhe 2 abstenime.

Kryesuesi i mbledhjes konstatoi: Informata e Planifikimit dhe realizimi i mbjelljeve pranverore për vitin 2026 u miratua dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 10

Kryesuesi i mbledhjes Safet Kamberi hapi diskutimin lidhur me Kërkesën për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara në vitin 2025 dhe vitet paraprake në vitin 2026.

Igballe Islami: Duke iu referuar deklarimeve se arsimi është prioritet i qeverisjes komunale, kërkoi sqarime lidhur me një informacion të publikuar në opinion se mjetet e destinuar për shkollat janë shpenzuar për nevoja të tjera, konkretisht për furnizim me lule në kuadër të Drejtorisë së Infrastrukturës dhe Shërbimeve Publike. Ajo theksoi se nuk dëshiron të reagojë pa pasur informacione të sakta për gjendjen faktike dhe kërkoi nga drejtori sqarime lidhur me këtë çështje. Gjithashtu, duke qenë se diskutimi lidhet me bartjen e të hyrave, kërkoi nga ju drejtor që të na e sillni për Kuvend një raport të detajuar mbi buxhetin e shpenzuar në shkolla, përfshirë destinimin dhe realizimin e mjeteve buxhetore.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesi vuri në votim Kërkesën për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara në vitin 2025 dhe vitet paraprake në vitin 2026, me propozimin që Kërkesës për bartje t'i shtohet pika si në vijim: Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet Vendimi Nr. 02-060/01-0021467-3/26 dt. 29.04.2026 Për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2025 dhe vitet paraprake në buxhetin e vitit 2026.

Rezultati i votimit: 5 për, 0 kundër dhe 2 abstenime.

Kryesuesi i mbledhjes konstatoi: Kërkesa për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara në vitin 2025 dhe vitet paraprake në vitin 2026, me propozimin që Kërkesës për bartje t'i shtohet pika si në vijim: Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet Vendimi Nr. 02-060/01-0021467-3/26 dt. 29.04.2026 Për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2025 dhe vitet paraprake në buxhetin e vitit 2026, u miratua dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Mbledhja përfundoi punimet në ora 11:32 min.

Mitrovicë

Procesmbajtës:

Kryesuesi i Kuvendit

Afërdita MAXHUNI

Safet KAMBERI



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	08.07.2026
REFERENC-Ë:	01-052/01-0039223/26
PËR/ZA/TO:	z. Faton Peci – Kryetar i Komunës
CC:	z. Safet Kamberi- Kryesues i Kuvendit Komunal dhe Anëtarët e Kuvendit të Komunës
NGA/OD/FROM:	Xhevdet Aruqaj Kryetar i Komisionit për Hartimin e Draft-Rregullores për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Komunale Nr.01/2023, për Shfrytëzimin e Përkohshëm të Sipërfaqeve dhe Hapësirave Publike.
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport mbi procesin e hartimit të Draft-Rregullores për Plotësim- Ndryshimin e Rregullores Nr.01/2023, për Shfrytëzimin e Përkohshëm të Sipërfaqeve dhe Hapësirave Publike.



Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës së Mitrovicës së Jugut Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020), nenin 14, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, të Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, nenin 32 paragrafi 1 dhe Vendimin Nr. 01-020/04-0025383-2/26, datë 13.05.2026, Komisioni për Hartimin e Rregullores për Plotësim- Ndryshimin e Rregullores Nr.01/2023, paraqet këtë:

Raport mbi procesin e hartimit të Draft-Rregullores për Plotësim- Ndryshimin e Rregullores Nr.01/2023.

Komisioni i formuar me Vendim për Hartimin e Rregullores për Plotësim-Ndryshimin e Rregulloren Nr.01/2023 për Shfrytëzimin e Përkohshëm të Sipërfaqeve dhe Hapësirave Publike.

Komisioni ka zhvilluar procedurën për hartimin e Draftit të Rregullores për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores Nr.01/2023 për Shfrytëzimin e Përkohshëm të Sipërfaqeve dhe Hapësirave Publike, konform dispozitave të Rregullores së (MAPL)-së. Nr.02/2021, për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të akteve të Komunës dhe aktet tjera relevante.

Në hapin e parë të zhvillimit të këtij procesi, me datën 28/05/2026 ju kemi drejtuar me e-mail zyrtarë Drejtorëve të Drejtorive në Komunën e Mitrovicës së Jugut, njësisë që kanë rol të veçantë në administratën e Komunës, që në afat prej 3 ditësh të na dërgojnë propozimet e tyre me qëllim të përfshirjes së tyre në hartimin e draftit të kësaj rregulloreje. Nga të gjitha drejtoritë, vetëm nga Drejtoria për Inspektion kemi pranuar sugjerime.

Komisioni konsideron se versioni përfundimtar i Draft Rregullores i prezentuar i plotëson kushtet dhe kriteret ligjore, qoftë ato materiale dhe procedurale dhe si i tillë mund të procedohet për votim në seancën e ardhshme të Kuvendit.

Me respekt.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

RREGULLORE NR. ____/____,
PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 01/2023
PËR SHFRYTËZIMIN E PËRKOHSHËM TË SIPËRFAQEVE DHE HAPËSIRAVE
PUBLIKE

Korrik , 2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. _____ dt. _____

Mitrovicë

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 pika c të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Rregullorës (MAPL) Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin të Akteve të Komunës, nenin 13, paragrafi 1.3 të Statutit të Komunës së Mitrovicës së Jugut, Nr 02-060/01-0056607/20-4 dt.24.09.2020 Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë _____, miraton këtë:

RREGULLORE NR. ____ / _____

PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORËS NR. 01/2023 PËR SHFRYTËZIMIN E PËRKOHSHËM TË SIPËRFAQEVE DHE HAPËSIRAVE PUBLIKE

Korrik, 2026

Neni 1

Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2023 për Shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve dhe hapësirave publike.

Neni 2

Neni 3, paragrafi 2 i Rregullores bazë fshihet dhe riformulohet si në vijim:

2. Varësisht nga nevoja për zhvendosjen e tyre nga një lokacion në tjetrin, pa u dëmtuar konstruksioni fizik i tyre, konsiderohen këto objekte:

2.1. Mbishkrimi (firma), Panot dhe Tabelat reklamuese dhe kuti me ndriqim

2.2. Totem reklamues

2.3. Banerët, Reklama të varura, baner rrugor,

2.4. Citylight/MUPI

2.5. Panot murale, reklamat në fasadë, çati dhe skele

2.6. Bill board klasik

2.7. Tri-Vision Billboard

2.8. Rrethojat e përkohshme dhe pengesat e ndryshme

2.9. Pllakatet reklamuese-sipërfaqet reklamuese të pllakatave

2.10. Ekranet reklamuse elektrik

2.11. Tabelat reklamuese me kinoprojektor

2.12. Tabelat reklamuese digjitale, billboard digjital

2.13. Video Wall

Neni 3, paragrafi 5, i shtohet një paragrafi 5.12 dhe atë:

5.12 Terasat për lokale afariste.

Neni 3

Neni 4, paragrafi 1 i Rregullores bazë fshihet në tërësi dhe riformulohet si në vijim:

1. Vendosja e Objekteve nga neni 3, të kësaj Rregullore, lejohet nëse janë plotësuar këto kushte:

1.1. Të mos cenohen sipërfaqet e trotuareve me gjerësi më të vogël se 2m.

1.2. Në udhëkryqet e rrugëve të mos zvogëlohet pamja, dhe të mos rrezikohet siguria në trafik.

1.3. Të mos pengohet lëvizja e këmbësoreve dhe çiklistave dhe automjeteve

- 1.4. Të respektohet distanca nga rrugët publike konform me Ligjin për rrugët.
- 1.5. Të mos pengohet shfrytëzimi normal i objekteve ekzistuese.
- 1.6. Të mos kufizohet hyrja ose qasja në objekte apo locale fqinje. Të mos pengohet funksionimi i objekteve përreth.

Neni 4

Neni 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 3 i Rregullores bazë ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

3.1 Çdo përsëritje e shënimeve të cekura në paragrafët 8.1. dhe 8.2. të këtij neni pavarësisht madhësisë, formës së shkruarjes, formës së vendosjes së tyre, vendit të shkruarjes apo vendit të vendosjes, e shkruar dhe e vendosur në sipërfaqe publike apo sipërfaqe individuale, me qëllim të reklamimit të veprimtarisë afariste, do të konsiderohet objekt reklamues.

Ndryshohet dhe riformulohet paragrafi 5 i nenit 8 Rregullorës Bazë dhe atë:

5. Në një kërkesë mund të përfshihen një apo më tepër objekte reklamuese, për çka pagesa bëhet për secilën objekt të vendosur.

Ndryshohet dhe riformulohet paragrafi 8 i nenit 8 të Rregullorës Bazë dhe atë:

Kërkesës duhet t'i bashkëngjitet:

- 8.1 Kopja e letërnjoftimit të pronarit dhe kërkesëdorëzuesit.
- 8.2 Certifikata e biznesit
- 8.3 Aplikacioni
- 8.4 Fotografia e reklames
- 8.5 Skicen (për aplikimin për herë të parë)

Neni 5

Nenit 9, paragrafi 1 i Rregullores bazë ndryshon dhe riformulohet si në vijim:

1. Për vendosje të reklamës, panos reklamuese dhe tabelës reklamuese, reklamave kuti, totem dhe pllakatet reklamuese sipas Lejes së DPU-së, vlera për pagesë përcaktohet sipas zonës së qytetit (si më poshtë), si dhe kohëzgjatja - vjetore apo periudha e caktuar sipas kërkesës:

- 1.1 Zona e parë 4.50€ /1 m²për një muaj.
- 1.2 Zona e dytë 3.00€ /1 m² për një muaj.
- 1.3 Zona e tretë 1.50€ /1 m² për një muaj.

Neni 6

Ekranet elektronike reklamuese, tabelat reklamuese me kinoprojektor dhe tabelat reklamuese digjitale

Neni 10, paragrafi 1, I Rregullorës bazë, ndryshohen dhe riformulohet teksti si në vijim:

1. Tarifa për vendosjen e ekraneve elektronike reklamuese, tabelave reklamuese me kinoprojektor, tabelat reklamuese digjitale, billboardëve digjitale dhe video wal, leja lëshohet nga DPU.

Kërkesës duhet ti bashkangjitet:

- 1.1 Kopja e letërnjoftimit të pronarit të biznesit dhe kërkes dorëzuesit;
- 1.2 Certifikata e biznesit dhe e pronës;
- 1.3 Skica e lokacionit;
- 1.4 Atesti teknik dhe elektronik;
- 1.5 Statika dhe pesha e ekranit;
- 1.6 Pëlqimi i banorëve (2/3 e banorëve të njësive të ndërtesës) të cilët gjenden në atë anë të fasadës ku vendoset reklama, si dhe pëlqimi i poseduesit të pronës nëse aplikuesi nuk është pronar.
- 1.7 Dimensionet, tipi i ekranit, prjekti grafik dhe kohëzgjatja.

Neni 10, paragrafi 2 i Rregullores bazë fshihet dhe riformulohet si në vijim:

2 Tarifa për vendosjen e ekraneve elektronike reklamuese, tabelave reklamuese me kinoprojektor, billboardëve digjitale, video-wallëve dhe tabelatve reklamuese digjitale, pagesa behët për secilën zonë të qytetit, si në vijim:

Nën-paragrafet 2.1., 2.2. dhe 2.3 të paragrafit 2 të nenit 10 të Rregullores bazë mbesin të pa ndryshuara.

Neni 7

Pllakatet reklamuese, bill-boardet, city-lightat, pano murale dhe banerët

Ndryshohen dhe riformulohen nën-paragrafët 1.1 dhe 1.4 të paragrafit 1 të nenit 11 të Rregullorës bazë si dhe shtohet nën-paragrafi 1.5 si në vijim:

- 1.1 Billboard klasik;
- 1.4 Banerët, reklamat e varura, baner rrugor;
- 1.5 Tre Vision

Ndryshohen dhe riformulohen nën-paragrafët 1, 2 dhe 3 i paragrafit 3 të nenit 11 të rregullores bazë dhe atë:

- 3.1 Kopja e letërnjoftimit të pronarit dhe kërkes dorëzuesit
- 3.2 Certifikata e biznesit dhe e pronës

3.3 Pëlqimi nga ministria përkatëse apo institucioni përkatës

Nenit 11, paragrafet 5.1, 5.2, 5.3, 5.4 të Rregullores bazë ndryshojnë dhe riformulohen si në vijim:

5.1 Për bill-board	5.50 € për 1m ² për një muaj;
5.2 Për city-light	3.50 €, për 1m ² për një muaj;
5.3 Për panot murale	3.50 €, për 1m ² për një muaj;
5.4 Për baner	3.50 €, për 1m ² për një muaj;
5.5 Tre Vision	4.50 €, për 1m ² për një muaj.

Ndryshohet dhe riformulohet paragrafi 5 I nenit 11 I Rregullorës bazë dhe atë:

5. Përzgjedhja e përfituesve (subjekteve juridike) për vendosje të objekteve reklamuese të cekura në nenin 3 të kësaj rregulloreje, bëhet përmes shpalljes (konkursit) publik.

Fshihet paragrafi 7 i nenit 11 të rregullorës bazë.

Neni 8

Kabinat (foltoret) publike telefonike

Neni 12, paragrafi 1. ndryshohet dhe riformulohet teksti si në vijim:

1. Për vendosjen e kabinave publike telefonike, kërkesës duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente:

Neni 9

Neni 14: Kiosqet

Neni 14, paragrafit 2 të Rregullorës bazë i shtohen nënparagrafi 2.1, 2.2, 2.3 dhe atë si në vijim:

2.1 Nuk lejohet vendosja e çfarëdo objekti në afërsi apo pranë kioskut

2.2 Për caktimin e sipërfaqes për vendosje të kiosqeve, vendos Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm, në përputhje me kushtet e pëcaktuara me Rregullore.

2.3 Kërkesës i bashkëngjiten këto dokumente:

2.3.1 Kopja e leternjoftimit të pronarit

2.3.2 Certifikata e biznesit;

2.3.3 Certifikata e OJQ-së;

Paragrafi 3, I nenit 14 i Rregullores, fshihet në tërësi.

Paragrafi 4, I nenit 14 i Rregullores bazë ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

3. Tarifa për sipërfaqen e lejuar, për vendosje të kioskut, është 6.00 €, për 1m² për muaj.

Neni 14, të Rregullores bazë i shtohet paragrafi 5, si në vijim:

5. Lejohet për kohë të caktuar vendosja në sheshet kryesore të qytetit, shtëpizat të tipit montues demontues nga materili i lehtë kryesisht nga druri etj, të dedikuara për organizim të aktiviteteve kulturore dhe argëtuese për “Festat e Fundvitit” si dhe ato që organizohen në sezonën e verës të njohura si “Ditët e Diasporës” në kohëzgjatje për 30 ditë.

5.1 Për caktimin e sipërfaqes për vendosje të shtëpizave, vendos Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm, në përputhje me kushtet e pëcaktuara me Rregullore.

5.2 Kërkesat individuale për vendosje të shtëpizave, nuk do të shqyrtohen, përveç si subjekte apo shoqëri të regjistruara si operator apo OJQ.

5.3 Tarifa për sipërfaqen e lejuar për vendosje të shtëpizave me sipërfaqe deri në 8 m² në sheshet kryesore të qytetit, është 100.00 €, për 1 shtëpizë.

Neni 10

Ndryshohet dhe riformulohet titulli i nenit 15 si në vijim:

Vendosja e tavolinave dhe karrigeve në sipërfaqet publike për lokalet shërbyese hoteliere

Ndryshohet dhe riformulohet paragrafi 1 i nenit 15 si në vijim:

1. Vendosja e tavolinave dhe karrigeve si dhe çadrave lëvizëse në sipërfaqet publike lejohet pranë lokaleve në afërsi të lokaleve, si dhe në lokacione të tjera të përcaktuara dhe miratuara nga Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm, në përputhje me kushtet e përcaktuara me Rregullore. Kërkesës i bashkangjiten këto dokumente:

1.1 Kopja e letemjofimit të pronarit;

1.2 Certifikata e biznesit.

Ndryshohet dhe riformulohet paragrafi 2 i nenit 15 si në vijim:

2. Leja për vendosje të këtyre objekteve, do të lëshohet për periudhën kohore nga data 1 prill deri më datën 30 shtator, që konsiderohet si (periudhë sezonale). Gjithashtu edhe për muajt në vijim nëse e shfrytëzojnë hapësirën publike, do të paguhet taksa sipas Rregullorës së miratuar.

Ndryshohet dhe riformulohet paragrafi 3 i nenit 15 si në vijim:

3. Tarifa për vendosje të tavolinave dhe karrigeve në këto sipërfaqe, paguhet sipas zonave të qytetit:

- 3.1 Zona e parë 5.00€ 1 m² për një muaj
- 3.2 Zona e dytë 3.00€ 1 m² për një muaj
- 3.3 Zona e tret 2.00€ 1 m² për një muaj

Neni 11

Neni 16: Sipërfaqet dhe hapësirat gjelbëruese

Në Nenin 16, Fshihet paragrafi 3, i Rregullores ndryshohet në tërësi dhe riformulohet si në vijim:

3. Në këto sipërfaqe publike lejohet shfrytëzimi, vetëm në rastet e mbajtjes së ndonjë eventit për qytetarë si: ndonjë koncert, apo mbrëmje muzikore në ambient të hapur, shfaqje teatrore, poezi dhe aktivitete kulturore, kinema verore dhe shfaqje filmash në park, gara sportive, maratona aktivitete rekreative, takime komunikative me qytetar etj.

Neni 16, I shtohet paragrafi 4 dhe atë si në vijim:

4. Këto aktivitete lejohen për tu mbajtur në parqet e qytetit dhe sipërfaqet gjelbëruese vetëm me pëlqimin e lëshuar nga Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm.

Neni 12

Neni 17, të Rregullores bazë i shtohet një paragrafi 6, dhe atë si në vijim:

6. Lejohet vendosja e tavolinave dhe karrigeve me kërkesë të arsyetuar të biznesit përtej terrasave të mbyllura në shetitoret dhe sheshet, kur konstatohet se për shkak të frekuentimit të lartë të qytetarëve nevojitet sipërfaqe shtesë për zhvillimin e veprimtarisë me kusht që të mos pengohet qarkullimi i këmbësoreve, qasja e emergjencave dhe funksionimi normal i sipërfaqes dhe hapësirës publike, në përputhe me kushtet e përcaktuara nga Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm

Neni 13

Neni 18: Stendat e hapura lëvizëse

Neni 18, paragrafi 1 ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

1. Vendosja e stendave të hapura lëvizëse, për shitjen e gjësendeve si: Librit jo shkollor, fotografive artistike, panoramave, lotarive, tiketave për lojëra të fatit, dhe lodra për

fëmije, bileta për lojëra të sportit, koncerte, produkte artizanale, suvenire dhe punime artistike, ekspozimi dhe promovimi i aktiviteteve kulturore, turistike dhe sportive, shitja e luleve, fidaneve për festat e marsit lejohet në sipërfaqet maksimale deri në $2m^2$

Nenit 18, paragrafi 3 i Rregullores bazë ndryshon dhe riformulohet si në vijim:

3. Tarifa për vendosje të stendave të hapura lëvizëse, bëhet sipas zonave të qytetit teksti sin në vijim:

3.1 Zona e parë..... $2.00 \text{ €} / m^2$ për një ditë;

3.2 Zona e dytë..... $1.00 \text{ €} / m^2$ për një ditë;

3.3 Zona e tretë $0.50 \text{ €} / m^2$ për një ditë.

Neni 14

Ndryshohet dhe riformulohet titulli i nenit 19 si në vijim:

Vendosja e pajisjeve për shitje të akulloreve, pijeve freskuese etj.

Neni 19, të Rregullores bazë paragrafi 1 ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

1. Lejohet vendosja e pajisjeve të lëvizshme për shitjen e akulloreve dhe pijeve freskuese, si: autofrigoriferë, frigoriferë statik për shitje të akulloreve, aparate për përgatitjen e lëngjëve freskuese, si dhe frigoriferë për pije freskuese. Këto pajisje mund të vendosen vetëm në lokacionet e miratuara nga autoriteti kompetent dhe për periudhën sezonale, nga 1 prilli deri më 31 tetor të vitit kalendarik, kërkesës duhet t' i bashkëngjiten këto dokumente:

1.1 Kopja e letemjofimit të pronarit;

1.2 Certifikata e biznesit.

Nenit 19, i Rregullores bazë, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.1, ndryshon dhe riformulohet dhe shtohet nën-paragrafi 2.4 si në vijim:

2.1 Frigorifer statik për akullore 50.00€ /për një muaj.

2.4 Aparat për përgatitjen e lëngjëve freskuese. 50.00€ për një muaj.

Nenit 19, i Rregullores bazë shtohet paragrafi 3, si në vijim:

3. Tarifa për vendosje të frigoriferit statik për pije freskuese, pran lokaleve afariste bëhet sipas zonave të qytetit:

- | | | |
|-----------|--------------|------------------------------------|
| 3.1 | Zona e parë | 20 € / lm^2 për nje muaj; |
| 3.2 | Zona e dytë | 15 € / lm^2 për një muaj; |
| 3.3 | Zona e tretë | 10 € / lm^2 për një muaj. |

Neni 15

Neni 23, fshihet dhe Riformulohet si në vijim:

Neni 23: Terasat për lokale afariste

1. Terasat e lokaleve afariste mund të vendosen, para, anash ose në afërsi të lokalit afaristë, si dhe në lokacione të tjera të përcaktuara nga Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm në përputhje me kushtet, kriteret urbanistike, destinimin e sipërfaqes dhe hapësirës të përcaktuara me këtë Rregullore.

2. Terasat duhet të harmonizohen me karakterin, formën dhe pozicionin e lokalit afarist ne qofte se nuk është afër lokalit vendos organi kompetent dhe duhet të përshtaten me ambientin përreth. Ato duhet të kenë konstruksion fleksibil dhe të jenë të sigurta për përdorim.

3. Aplikimi për vendosjen e terasave të mbyllura, me konstruksion të montueshëm dhe çmontueshëm prej metali, alumini ose druri, me mbështjellje prej plastike ose qelqi, bëhet për periudhën më pak se 1 (një) vitë me mundesi ripërtritjeje në përputhje me këtë Rregullore.

4. Terasat e mbyllura të vendosura në sipërfaqet publike mund të shfrytëzohen për ushtrimin e veprimtarisë së subjektit afarist për të cilin është lëshuar leja, përfshirë veprimtaritë hotelerike, kafiterit, tregtare, sherbyese dhe veprimtari të tjera të ngjashme që janë në përputhje me destinimin e hapësirës, legjislacionin në fuqi dhe kushtet e përcaktuara nga organi kompetent.

5. Vendosja e ketyre terasave për lokalet afariste lejohet prej 4.00 deri në 5.00m, e matur nga vija e fasadës (vitrinës) së lokalit në drejtim të sipërfaqës dhe hapsirës publike me kusht që të mos pengohet qarkullimi i këmbësorëve, qasja në objekte publike dhe funksionimi i hapsirës publike.

6. Përjashtimisht kur organi kompetent Komunal vlerëson se ekzistojnë kushte dhe interes publik, mund të lejohet vendosja e terasave edhe në pjesë të sheshit ose hapësirës publike, për një periudhë të caktuar kohore. Në keto raste, subjekti afarist pajiset me leje të përkohshme, në të cilën përcaktohen vendodhja, sipërfaqja, kohëzgjatja e shfrytëzimit dhe kushtet e tjera përkatëse.

7. Vendosja e këtyre terasave lejohet për këto veprimtari:

- 7.1 Bizneset që ushtrojnë veprimtari shërbyese hoteliere;
- 7.2 Bizneset që ushtrojnë veprimtari tregtare;
- 7.3 Aktivitete për OJQ-te, aktivitete fetare, dhe te ndryshme.

8. Kërkeses për vendosje të këtyre terasave duhet ti bashkëngjiten këto dokumente:

8.1 Kopja e letemjofimit;

8.2 Certifikata e regjistrimit të biznesit;

8.3 Te banesat kolektive me afarizem në qoftë se kemi ankesa të banorëve kërkohet ta kemi një pëlqim nga banoret me nënshkrime të njesive banesore me 51% e nënshkrimeve të njesive banesore.

9. Tarifa për vendosje të terasave për lokalet afariaste në sipërfaqet dhe hapësirat publike, bëhet sipas zonave të qytetit:

8.4 Zona e parë 6.00 € / 1m² për muaj;

8.5 Zona e dytë 4.00 € / 1m² për muaj;

8.6 Zona e tretë 2.50 € / 1m² për muaj.

10. Terasat e mbyllura lejohen për kohë zgjatje maksimum deri në 11 muaj

Neni 16

Neni 24 I rregullorës bazë fshihet dhe riformulohet si në vijim

1. Vendosja e lojërave për fëmijë dhe pajisje argëtuese lejohet vetëm në hapësira dhe sipërfaqe të cilat i përcakton Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm.

2. Tarifa për vendosje të lojërave, paguhet sipas zonave të qytetit,

3.1 Zona e parë ...3.00 € 1m² / për një muaj.

3.2 Zona e dytë ...2.00 € 1m² / për një muaj.

3.3 Zona e tretë ...1.00 € 1m² / për një muaj.

3. Paisjet e lojërave për të cilat kërkohet atesti teknik: për të gjitha paisjet e lojërave që instalohen në mënyrë të përhershme në sipërfaqet publike dhe paraqesin rrezik nga lartësia, lëvizja ose ngarkesa mekanike është i detyrueshëm atesti teknik. Këtu përfshihen luhatëset, rrëshqitëset, karuselet e medhaja, balancuesit, paisjet me susta, kullat dhe komplekset e lojës teleferike.

4. Lejohet vendosja e pajisjeve argëtuese ose rekreative, si makinerit e boksit, pajisjet elektrike argëtuese dhe pajisje të tjera të ngjashme, të cilat nuk i nënshtrohen dispozitave që rregullojnë këndet e lojrave për fëmijë.

5. Vendosja e këtyre pajisjeve në sipërfaqet dhe hapësirat publike bëhet vetëm me leje të organit kompetent komunal. Pajisjet duhet të vendosen në mënyrë që të mos pengojnë qarkullimin e këmbësorëve, sigurinë publike dhe funksionimin normal të sipërfaqes dhe hapësirës publike,

Organi kompetent mund të refuzojë kërkesën kur vlerëson se vendosja e pajisjeve cenon sigurinë, rendin publik.

6. Kërkesa për pajisjen me leje duhet të përmbajë

- 6.1 Kopja e letërnjoftimit të pronarit.
- 6.2 Certifikata e biznesit.
- 6.3 Fotografia e lokacionit.
- 6.4 Atesti teknik për disa lloje të lojërave ku ka rrezikshmeri nga maqinerit të ndryshme

7. Tarifa për vendosje të pajisjeve argëtuese ose rekreative, si makinerit e boksit , Tarifohet sipas zonave të qytetit dhe atë:

7.1 Zona e parë ...25.00 € 1m² / për një muaj.

7.2 Zona e dytë ...15.00 € 1m² / për një muaj.

7.3 Zona e tretë ...10.00 € 1m² / për një muaj.

Neni 17

Neni 30 I Rregullores bazë ndryshohet dhe riformulohet në tërësi si në vijim:

Neni 30: Dispozitat ndëshkuese

- 1. Me gjobë 150€ deri 300€ do të gjobitet personi juridik ose fizikë i cili vendos objekte, stenda lëvizëse, pajisje për shitjen e pofkave, misrit, akullloreve, pomfritit petullave, pallagaqeve, frigorifer dhe artikujve të ngjashëm si dhe produkte bujqësore dhe blegtorale në hapësira publike pa marrë leje nga organi kompetent, respektivisht pa e vazhduar lejen paraprake pas skadimit të afatit.
- 2. Me gjobë 300€ deri 500€ do të gjobitet personi juridik ose fizikë i cili vendos në hapësira publike pa marrë leje nga organi kompetent, respektivisht pa e vazhduar lejen paraprake pas skadimit të afatit si në vijim: lodra të ndryshme, kioskë, tavolina, karrika dhe reklama.
- 3. Me gjobë 500€ deri 900€ do të gjobitet personi juridik ose fizikë i cili vendos në hapësira publike pa marrë leje nga organi kompetent, respektivisht pa e vazhduar lejen paraprake pas skadimit të afatit si në vijim: vendos mjete apo pajisje në hapësira gjelbëruese, vendosë në hapësira publike gjenerator, automjete lëvizëse për shitjen e ushqimit dhe pijeve, vendosë në trotuare mallra para lokaleve afariste, vendos pano reklamuese, bill board, city light, pano murale, baner, ekran elektronik reklamues, tabela reklamuese digjitale dhe te ngjajshme

Neni 18

Mbikëqyrja dhe zbatimi

Përrgjegjëse për Mbikëqyrje të zbatimit të dispozitave të kësaj Draft-Rregulloreje, janë: Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm, Drejtoria për Inspektion dhe Drejtoria për Financa dhe Zhvillim Ekonomik

Neni 19

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore shpallet 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë Përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

MITROVICË

KRYESUESI I KUVENDIT

Safet Kamberi



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-020/04-0025383-2/ dt. 13.05.2026
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, dhe Propozim-Vendimin Nr. 01-020/04-0025383/26, dt. 05.05.2026, të Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm, Kryetari i Komunës sjell këtë:


V E N D I M

(Për formimin e Komisionit për hartimin e Draft – Rregullores për Ndryshim/Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2023 Për Shfrytëzimin e Përkohshëm të Sipërfaqeve dhe Hapësirave Publike)

- 1. FORMOHET** Komisioni për hartimin e Draft – Rregullores për Ndryshim/Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2023 Për Shfrytëzimin e Përkohshëm të Sipërfaqeve dhe Hapësirave Publike, në këtë përbërje:
 - 1.1** Xhevdet Aruqaj – kryetar (DPU);
 - 1.2** Mevlyde Shala Peci – anëtare (DBF);
 - 1.3** Bedri Muja – anëtar (DI);
 - 1.4** Shenaj Llapashtica – anëtare (DPU);
 - 1.5** Erduan Jashari – anëtar (DPU);
- Komisioni është përgjegjës që të bëjë hartimin e Draft - Rregullores për Ndryshim/Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2023 Për Shfrytëzimin e Përkohshëm të Sipërfaqeve dhe Hapësirave Publike, duke përfshirë të gjitha propozimet nga drejtoritë komunale që implikohen në zbatimin e saj, dhe të bëjë harmonizimin e tyre me dispozitat ligjore pozitive në fuqi.
- Komisioni në fjalë obligohet që pas hartimit të Draft - Rregullores së lartcekur të njëjtën ta procedojë në Kuvendin e Komunës për Shqyrtim dhe Miratim përmes Kryetarit të Komunës.
- Komisioni punues bazë për punën e tij do të ketë: Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Statutin e Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, Rregulloren (MAPL) Nr. 02/2021 për Hartimin dhe Publikimin e Akteve të Komunës, Rregulloren Nr. 01/2023 Për Shfrytëzimin e Përkohshëm të

Sipërfaqeve dhe Hapësirave Publike si dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.

5. Komisioni i formuar sipas pikës një (1) të këtij Vendimi obligohet që të hartoj Draft-Rregulloren në afat më së largu brenda 3 (tre) muajsh, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryetari i Komunës

Faton PEÇI

Shtojcë:

Propozim-Vendimi Nr. 01-020/04-0025383/26, dt. 05.05.2026, të Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm

T'i dërgohet:

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Zyrës Ligjore
- 1x1 Zyrës për Informim
- 1x1 Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm
- 1x1 Anëtarëve të Komisionit
- 1x1 Arkivit



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Nr.prot.01-020/04-0025383/2/26
Datë 08.07.2026

Bazuar në dispozitat e nenin 68, të Ligjit nr. -3/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statuti i Komunës së Mitrovicës së Jugut, neni 17 pika 1.2 dhe neni 22 pika 2 e Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë dhe neni 14, nënparagrafi 1.5 i Rregullorës (MAPL) nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës Komisioni i formuar me vendim të Kryetarit të Komunës me nr.prot. 01-020/04-0025383-2/26 të datës 13.05.2026, organizon këtë:

KONSULTIM PUBLIK

Për


Draft- Rregullore për Plotësim dhe Ndryshim të Rregullores Komunale nr.01/2023 për Shfrytëzimin e Përkohshëm të Sipërfaqeve dhe Hapësirave Publike

Të nderuar qytetarë dhe Subjekte të Komunës së Mitrovicës së Jugut, ju njoftojmë se Draft-Rregullorja për Plotësim dhe Ndryshim të Rregullores Komunale nr.01/2023 për Shfrytëzimin e Përkohshëm të Sipërfaqeve dhe Hapësirave Publike, ka hy në fazën e Konsultimit Publik, për çka ju ftoj që të merrni pjesë në Konsultim Publik, i cili do të mbahet ditën e Hënë me datë **20.07.2026**, në Sallën e Mediave, kati i **I-rë** në objektin e Komunës së Mitrovicës së Jugut, duke filluar nga ora **10:30h**.

Të drejtë pjesëmarrje kanë të gjithë qytetarët dhe organizatat e ndryshme të Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Këtij njoftimi i bashkangjitet Draft-Rregullore për Plotësim dhe Ndryshim të Rregullores Komunale Nr.01/2023 për Shfrytëzimin e Përkohshëm të Sipërfaqeve dhe Hapësirave Publike, të cilën mund ta gjeni të Publikuar në Webfaqen zyrtare të Komunës së Mitrovicës së Jugut, <https://mitrovica.ejugut.rks-gov.net>.

Komentet dhe sugjerimet e juaja, mund t'i dërgoni deri me datë 24.07.2026 (e premte), në email adresën: xhevdet.aruqaj@rks-gov.net

Kryesues i Komisionit

Xhevdet Aruqaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut

Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATE/A:	16.07.2026
REFERENC-Ë:	02-352/14-0041195/26
PËR/ZA/TO:	z. Safet KAMBERI - Kryesuese e Kuvendit të Komunës
CC:	Anëtarët e Kuvendit të Komunës, Komiteti për Politikë e Financa,
NGA/OD/FROM:	z. Faton PEÇI, Kryetar i Komunës
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Propozim – VENDIM (Për organizimin e konkursit komunal dhe ndarjen e çmimeve për kopshtin, ballkonin, dhe sipërfaqen më të mirë të rregulluar para lokaleve afariste)

Në mbështetje të nenin 12, 17, 58, pika h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 13 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4 dhe neni 77, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.10 të Statutit të Komunës së Mitrovicës së Jugut dhe me qëllim të promovimit të mbrojtjes së mjedist, gjelbërimit urban, estetikës së hapsirave private dhe rritjes së ndërgjegjësimit qytetar për përmirësimin e ambientit jetësor, Kryetari i Komunës propozon Kuvendit të Komunës këtë:

Propozim - VENDIM

(Për organizimin e konkursit komunal dhe ndarjen e çmimeve për kopshtin, ballkonin sipërfaqen më të mirë të rregulluar para lokaleve afariste dhe atyre të gastronomisë)

1. Me këtë Vendim miratohet Propozim-Vendimi për organizimin e konkursit komunal dhe ndarjen e çmimeve për kopshtin, ballkonin, sipërfaqen më të mirë të rregulluar para lokaleve afariste dhe të atyre të gastronomisë në territorin e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

2. Ky konkurs ka për qëllim, promovimin e gjelbërimit dhe estetikës urbane, stimulimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në përmirësimin e ambientit jetësor dhe nxitjen e praktikave të qëndrueshme për mirëmbajtjen e oborreve, kopshteve dhe ballkoneve.
3. Në konkurs kanë të drejtë të marrin pjesë personat fizikë që kanë vendbanim në territorin e Komunës Mitrovicës së Jugut dhe që posedojnë ose shfrytëzojnë ligjërisht oborr, kopsht ose ballkon në territorin e komunës.
4. Konkursi organizohet në këto kategori:
 - 4.1. Kopshti më i mire (në pronë private);
 - 4.2. Ballkoni panoramik më i mire (në pronë private).
 - 4.3. Sipërfaqja më e mirë e rregulluar para lokaleve afariste;
 - 4.4. Sipërfaqja më e mirë e rregulluar para lokaleve të gastronomisë.
5. Vlera e këtij projekti-konkursi në total është 3500.00 Euro dhe ndahet në këto kategori sipas çmimeve:
 - 5.1.Çmimi për kopshtin më të mirë (oborre të rregulluara në pronë private) në vlerë prej 1000.00 Euro;
 - 5.2.Çmimi për ballkonin më të mirë (të rregulluar në pronë private) në vlerë prej 500.00 Euro;
 - 5.3.Çmimi për sipërfaqen më të mirë të rregulluar para lokaleve afariste në vlerë prej 1000.00 Euro
 - 5.4.Çmimi për sipërfaqen më të mirë të rregulluar para lokaleve të fushës së gastronomisë në vlerë prej 1000.00 Euro.
6. Obligohen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Mbrojtjen e Mjedisit, që brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij Vendimi, të shpallin konkursin publik, I cili duhet të përmbajë:
 - 6.1.Kushtet e pjesëmarrjes;
 - 6.2.Kriteret e vlerësimit;
 - 6.3.Afatin e aplikimit;
 - 6.4.Mënyrën e vlerësimit;
 - 6.5.Procedurën e shpalljes së fituesve.
7. Procedurën e vlerësimit e kryen Komisioni për Vlerësim në përbërje prej 5 anëtarësh, të cilin e emëron Kryetari i Komunës.
8. Pas përfundimit të procedurës së vlerësimit, Kryetari i Komunës miraton listën përfundimtare të fituesve. Çmimet ndahen në një ceremoni publike të organizuar nga Komuna.
9. Mjetet financiare paguhen në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe mjetet e planifikuara në buxhetin komunal, nga kategoria subvencione dhe transfere nga Drejtoria për Mbrojtjen e Mjedisit.

ARSYETIM

Komuna e Mitrovicës së Jugut, në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi të saja ligjore, ka për obligim të ndërmarrë masa dhe iniciativa që kontribuojnë në mbrojtjen e mjedisit, përmirësimin e cilësisë së jetesës, zhvillimin e estetikës urbane dhe promovimin e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në ruajtjen dhe përmirësimin e hapësirave të tyre jetësore dhe afariste.

Kjo iniciativë synon në rend të parë të promovoj kulturën e gjelbërimit, përgjegjësinë qytetare ndaj mjedisit si dhe rregullimin funksional e estetik, për një qytet të pastër mjedisor dhe estetikisht të rregulluar, fakte të cilat janë vlerësuar se organizimi i një konkursi komunal me karakter publik paraqet një instrument të përshtatshëm për stimulimin e qytetarëve dhe subjekteve afariste që, përmes angazhimit të tyre, të kontribuojnë në zbulimin e qytetit dhe përmirësimin e mjedisit jetësor. Përmes ndarjes së çmimeve synohet të vlerësohen dhe të promovohen shembujt më të mirë të mirëmbajtjes së hapësirave private dhe atyre para lokaleve afariste, duke krijuar një frymë pozitive konkurrence dhe duke nxitur pjesëmarrje edhe më të madhe në vitet e ardhshme.

Ky propozim-vendim mbështetet në kompetencat vetanake të komunës të përcaktuara me Ligjin nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, i cili u njeh komunave kompetenca në fushën e mbrojtjes së mjedisit, zhvillimit lokal dhe ofrimit të shërbimeve me interes publik lokal. Gjithashtu, ai mbështetet në Ligjin nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, i cili obligon institucionet publike të ndërmarrin masa për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit, promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe ngritjen e vetëdijes publike për çështjet mjedisore. Për më tepër, Statuti i Komunës së Mitrovicës së Jugut i njeh komunës kompetencat për ndërmarrjen e aktiviteteve dhe programeve që synojnë realizimin e interesit publik në nivel lokal.

Me qëllim të garantimit të transparencës, trajtimit të barabartë dhe besueshmërisë së procesit, propozohet që konkursi të zhvillohet përmes thirrjes publike, në të cilën do të përcaktohen kushtet e pjesëmarrjes, kriteret e vlerësimit, afatet për aplikim, procedura e shqyrtimit dhe mënyra e shpalljes së fituesve. Procedura e vlerësimit do të zhvillohet nga një komision profesional prej pesë (5) anëtarësh, i emëruar nga Kryetari i Komunës, i cili do të veprojë në mënyrë të paanshme dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara në konkurs.

Pas përfundimit të procedurës së vlerësimit, komisioni do t'i paraqesë Kryetarit të Komunës raportin përfundimtar me renditjen e kandidatëve dhe propozimin për fituesit, ndërsa lista përfundimtare do të miratohet nga Kryetari i Komunës. Ndarja e çmimeve do të realizohet në një ceremoni publike, me qëllim promovimin e vlerave të mbrojtjes së mjedisit dhe motivimin e qytetarëve për pjesëmarrje në programe të ngjashme në të ardhmen.

Mjetet financiare për ndarjen e çmimeve do të sigurohen nga kategoria buxhetore subvencione dhe transfere nga Drejtoria për Mbrojtjen e Mjedisit.

Duke marrë parasysh rëndësinë e promovimit të gjelbërimit, mbrojtjes së mjedisit, estetikës urbane dhe pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në përmirësimin e ambientit jetësor, konsiderohet se miratimi i këtij propozim-vendimi është në interes publik dhe do të ndikojë pozitivisht në përmirësimin e pamjes së qytetit, ngritjen e vetëdijes mjedisore dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet komunës, qytetarëve dhe komunitetit të biznesit.

Konsideroj se arsyet të cekura si më lartë janë të mjaftueshme që Kuvendi i Komunës së Mitrovicës së Jugut ta miratojë Propozim-vendimin për organizimin e konkursit komunal dhe ndarjen e çmimeve për kopshtin, ballkonin dhe sipërfaqen më të mirë të rregulluar para lokaleve afariste.

Me respekt



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica

DATË/A:	16.07.2026
REFERENCË/A	02-900/04-0041331/26
PËR/ZA/TO:	z. Safet Kamberi – Kryesues i Kuvendit ne Komunën e Mitrovicës se Jugut
CC:	z. Gazmend Asllani – Drejtor i Kulturës, Rinis dhe Sportit
PËRMES/ PREKO/ THROUGH:	z. Faton Peci - Kryetar i Komunës se Mitrovicës Jugore
NGA/OD/FROM:	z. Ramadan Beshiri - Drejtor i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale
TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT:	Propozim vendim për mbështetje financiare në shumën 500.00 euro për Sabri Çabra

Të nderuar,

Arsyetim për mbështetje financiare për qytetarin z. Sabri Çabra

Mbështetja financiare për z. **Sabri Çabra** është e arsyeshme dhe në interes publik, duke pasur parasysh se ai është person me aftësi të kufizuara dhe një sportist i suksesshëm që përmes angazhimit të tij po promovon përfshirjen, barazinë dhe fuqizimin e personave me aftësi të kufizuara.

Sabri Çabra është kampion i Kosovës në kategorinë **BC2** dhe fitues i Turneut të Parë të Kampionatit Boccia 2026. Si rezultat i këtyre arritjeve, ai do të përfaqësojë Republikën e Kosovës në **World Boccia Challenger – Pilsen 2026**, duke u bërë parasportisti i parë nga Kosova në sportin e boccias që merr pjesë në një garë zyrtare të **World Boccia**.

Përkrahja e tij është një investim në promovimin e sportit për personat me aftësi të kufizuara dhe në nxitjen e pjesëmarrjes së tyre aktive në jetën publike. Garat ndërkombëtare krijojnë mundësi për afirmim, integrim social dhe përfaqësim dinjitoz të qytetit të Mitrovicës dhe të Republikës së Kosovës.

Drejtorja e Mirëqenies Sociale, në kuadër të mbështetjes së personave me aftësi të kufizuara dhe promovimit të përfshirjes së tyre në shoqëri, propozon ofrimin e një mbështetjeje financiare simbolike për z. Sabri Çabra, si shenjë vlerësimi për sukseset e tij dhe për përfaqësimin e denjë të Mitrovicës dhe Kosovës në arenën ndërkombëtare.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica

DATË/A:	16.07.2026
REFERENCË/A	<i>02-400/04 - 0041333/26</i>
PËR/ZA/TO:	z. Safet Kamberi – Kryesues i Kuvendit ne Komunën e Mitrovicës se Jugut
CC:	z. Gazmend Gjoshaj – Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
PËRMES/ PREKO/ THROUGH:	z. Faton Peci - Kryetar i Komunës se Mitrovicës Jugore <i>PL</i>
NGA/OD/FROM:	z. Ramadan Beshiri - Drejtor i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale <i>Beshiri</i>
TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT:	Propozim vendim për mbështetje financiare në shumën 500.00 euro për OJQ “REC” - Mitrovicë

Të nderuar,

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjit për Shërbimet Sociale dhe Familjare, Statutit të Komunës së Mitrovicës dhe kompetencave të Drejtorisë për Mirëqenie Sociale, propozohet kjo mbështetje për OJQ “REC”.

Kërkohet mbështetja për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej **500.00 € (pesëqind euro)** për OJQ “REC”. Mbështetja financiare për OJQ-në REC është e arsyeshme dhe në interes publik, pasi organizata zbaton programe të trajnimit, mentorimit dhe avokimit që synojnë fuqizimin e personave me aftësi të kufizuara dhe rritjen e përfshirjes së tyre në tregun e punës.

Përmes këtyre programeve, përfituesit zhvillojnë aftësi profesionale, përgatiten për punësim, informohen mbi të drejtat e tyre dhe mbështeten në tejkalimin e barrierave që pengojnë integrimin ekonomik dhe social.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica

DATE/A:	16.07.2026
REFERENCË/A	02-403/04-0041335/26
PËR/ZA/TO:	z. Safet Kamberi – Kryesues i Kuvendit ne Komunën e Mitrovicës se Jugut
CC:	z. Gazmend Gjoshaj – Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
PËRMES/ PREKO/ THROUGH:	z. Faton Peci - Kryetar i Komunës se Mitrovicës Jugore
NGA/OD/FROM:	z. Ramadan Beshiri - Drejtor i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale
TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT:	Propozim vendim për mbështetje financiare në shumën 500.00 euro për OJQ “OPFAKOS” - Mitrovicë

Të nderuar,

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjit për Shërbimet Sociale dhe Familjare, Statutit të Komunës së Mitrovicës dhe kompetencave të Drejtorisë për Mirëqenie Sociale, propozohet kjo mbështetje për OJQ “OPFAKOS”.

Duke qenë se nevojat për këto shërbime janë në rritje, ndërsa kapacitetet institucionale nuk i mbulojnë plotësisht, mbështetja financiare e komunës është e domosdoshme për të siguruar vazhdimësinë dhe cilësinë e shërbimeve për përfituesit.

Financimi i OJQ-së “Opfakos” paraqet investim në mirëqenien e qytetarëve dhe në fuqizimin e shërbimeve sociale, duke siguruar që personat me aftësi të kufizuara të kenë qasje në trajtim dhe mbështetje profesionale në komunitetin e tyre.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica

DATE/A:	16.07.2026
REFERENCË/A	<i>02-400/04-0049337/26</i>
PËR/ZA/TO:	z. Safet Kamberi – Kryesues i Kuvendit ne Komunën e Mitrovicës se Jugut
CC:	z. Gazmend Gjoshaj – Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
PËRMES/ PREKO/ THROUGH:	z. Faton Peci - Kryetar i Komunës se Mitrovicës Jugore
NGA/OD/FROM:	z. Ramadan Beshiri - Drejtor i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale
TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT:	Propozim vendim për mbështetje financiare në shumën 500.00 euro për OJQ “SË BASHKU” - Mitrovicë

Të nderuar,


Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjit për Shërbimet Sociale dhe Familjare, Statutit të Komunës së Mitrovicës dhe kompetencave të Drejtorisë për Mirëqenie Sociale, propozohet kjo mbështetje për OJQ “SE BASHKU”.

Kërkohet mbështetja për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej **500.00 € (pesëqind euro)** për OJQ “SË BASHKU”. Mbështetja financiare për OJQ “Së Bashku” arsyetohet me rëndësinë e shërbimeve që kjo organizatë ofron për personat me aftësi të kufizuara në Komunën e Mitrovicës. Përmes programeve të rehabilitimit, trajtimit, zhvillimit të aftësive funksionale, mbështetjes psikosociale dhe integritimit në komunitet, organizata kontribuon drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së jetës së kësaj kategorie.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica



DATË/A:	06.07.2026
REFERENCË/A	
PËR/ZA/TO:	z. Safet Kamberi – Kryesues i Kuvendit ne Komunën e Mitrovicës se Jugut
CC:	z. Gazmend Gjoshaj – Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
PËRMES/ PREKO/ THROUGH:	z. Faton Peci - Kryetar i Komunës se Mitrovicës Jugore
NGA/OD/FROM:	z. Ramadan Beshiri - Drejtor i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale
TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT:	Propozim vendim për mbështetje financiare në shumën 500.00 € për OJQ “Zëri i Prindërve”

Të nderuar,

OJQ “Zëri i Prindërve” zhvillon aktivitete me interes social dhe humanitar, duke ofruar mbështetje dhe përfaqësim për familjet që përballen me sfiden e personave të zhdukur gjatë luftës me dhunë dhe viktimat civile.

Duke vlerësuar kontributin e kësaj organizate në fuqizimin e familjeve dhe punën rreth zbardhjes së rastit të personave të zhdukur gjatë luftës në Komunën e Mitrovicës, propozohet që Kuvendi Komunal të miratojë ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 500.00 €, për mbështetjen e aktiviteteve dhe funksionimit të saj.

Kjo mbështetje përfaqëson një investim në mirëqenien sociale dhe në forcimin e solidaritetit dhe vlerësim për punën OJQ “Zëri i Prindërve”. Të bashkangjitur gjeni edhe kërkesën e OJQ “Zëri i Prindërve” me përfaquese znj. Xhyle Haziri.



OJQ "Zëri i Prindërve", Muzeu i Qytetit pn, Mitrovicë, 40000
Tel, +38349454059 email: zeriprindrve@yahoo .com

KËRKESË PËR PERKRAHJE

Drejtuar : z. Ramadan Beshiri kryetarit Mirqenjes Sociale

- (OJQ): Organizata Zeri i Prindërve për Personat e Zhdukur
- Numri i regjistrimit: 5112543-6
- Drejtori Ekzekutiv: Gjyla Haziri
- Nr.personal: 1000903970
- Nr : NLB banka 17-17-0016 00012586
- Zeri i Prindërve (ZP)
- Adresa: (Sheshi i Jasharajve)
- Komuna: (Mitrovicë)
- Telefoni: (+383 49 454 059)
- E-mail adresa: zeriprindrve.@ yaho.com

Shoqata zeri i prindërve është themeluar në vitin 2001 me vendimin 5112543-6 për hulumtimin e të zhdukurve dhe viktimave civile në Mitrovicë me rrethin.

Per 27 vite mbas permbarimit të luftës 1998-99 shoqata ka punuar dhe kujdestaruar vullnetare , Komuna ka perkrah një her në vit per 12 muj një shum jo edhe të bollëshme por puna u bë pa u ndal asnjher .

104 persona të zhdukur ende na mungojnë

553 viktimave civile familjaret nuk hjekin dor kërkojnë drejtësi nga kryesit e krimeve , me kta familjar shoqata ballafaqohet rregullisht , për shkak të bashkpunimit dhe aktiviteve me familjar kërkojmë perkrahje nga Drejtoria e Mirqenjes Sociale si në vijim:

Mirmbajtja e zyres 20euro për qdo muj $12 \times 20 = 240$ euro në vit

Printer dhe skaner prej janarit nuk kemi ?

Interneti duhet për qdo muj mu pagu 120euro për $12 \times 10 = 120$ euro

Mirmbajtja bankare e shoqates nese ska qarkullim e mbyllin 12 euro per muj

Vizita tek familjaret transporti

Hargjime

Hargjime tjera kopje jasht zyres
Sanitare 100euro

Totali 500 euro për këtë vit e mbyllin

Ju falrnderit për mirkuptim shpresojm në perkrahjen e juaj

Data :06/07/2026
Mitrovicë



kryetare e shoqatës Gjyla Haziri



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica



DATË/A:	06.07.2026
REFERENCË/A	
PËR/ZA/TO:	z. Safet Kamberi – Kryesues i Kuvendit ne Komunën e Mitrovicës se Jugut
CC:	z. Gazmend Gjoshaj – Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
PËRMES/ PREKO/ THROUGH:	z. Faton Peci - Kryetar i Komunës se Mitrovicës Jugore
NGA/OD/FROM:	z. Ramadan Beshiri - Drejtor i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale
TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT:	Propozim vendim për mbështetje financiare në shumën 500.00 euro për OJQ “HANDIKOS” - Mitrovicë

Të nderuar,

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjit për Shërbimet Sociale dhe Familjare, Statutit të Komunës së Mitrovicës dhe kompetencave të Drejtorisë për Mirëqenie Sociale, propozohet kjo mbështetje pas kërkesë së OJQ “HANDIKOS”.

Kërkohet mbështetja për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej **500.00 € (pesëqind euro)** për OJQ “Handikos” – Mitrovicë, për mbështetjen e ofrimit të shërbimeve sociale dhe rehabilituese për personat me aftësi të kufizuara. Në bashkangjitje të propozim vendimit është edhe sqarimi i përfaqësuese së OJQ “Handikos” znj. Myrvete Hasani, e cila me kërkesën e saj më drejtuar se ka mungesë fondesh për ti realizuar shërbimet e nevojshme.

Mjetet financiare do të ndahen nga kategoria përkatëse buxhetore e Drejtorisë për Mirëqenie Sociale dhe do të përdoren për realizimin e aktiviteteve dhe shërbimeve sociale të ofruara nga OJQ “Handikos” – Mitrovicë.

OJQ “Handikos” – Mitrovicë ofron shërbime profesionale dhe rehabilituese për personat me aftësi të kufizuara, duke përfshirë:

- shërbime të ergoterapisë;
- shërbime të fizioterapisë;
- shërbime infermierike;
- mbështetje psikosociale;
- shërbime në terren për fëmijë dhe të rritur;
- edukim dhe mbështetje për familjet.

Arsyetimi: për ndarjen e mjeteve financiare bazohet në nevojën për mbështetjen dhe vazhdimësinë e shërbimeve sociale dhe rehabilituese që OJQ “Handikos” – Mitrovicë ofron për qytetarët e Komunës së Mitrovicës.

Bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë për Mirëqenie Sociale dhe OJQ “Handikos” është i një rëndësie të veçantë për identifikimin, referimin dhe mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara, si dhe për promovimin e të drejtave të tyre, eliminimin e barrierave fizike dhe sociale dhe krijimin e mundësive të barabarta për pjesëmarrje në shoqëri.

Mbështetja institucionale kontribuon në garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve cilësore, rritjen e pavarësisë funksionale të përfituesve dhe përmirësimin e mirëqenies së tyre sociale.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica



02-400/24 - 0040492/26
14.07.2026

DATË/A:	06.07.2026
REFERENCË/A	
PËR/ZA/TO:	z. Safet Kamberi – Kryesues i Kuvendit ne Komunën e Mitrovicës se Jugut
CC:	z. Gazmend Gjoshaj – Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
PËRMES/ PREKO/ THROUGH:	z. Faton Peci - Kryetar i Komunës se Mitrovicës Jugore
NGA/OD/FROM:	z. Ramadan Beshiri - Drejtor i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale
TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT:	Propozim vendim për përkrahjen e Shoqatës “Minatori ’89” në shumë prej 500.00 €

Të nderuar,

Shoqata “Minatori ’89” përfaqëson një organizim me vlera historike, shoqërore dhe qytetare, duke ruajtur dhe promovuar trashëgiminë, kontributin dhe sakrificën e minatorëve në proceset historike dhe shoqërore të vendit.


Duke vlerësuar rolin e kësaj shoqate në ruajtjen e kujtesës historike dhe organizimin e aktiviteteve me interes publik, propozohet që Kuvendi Komunal të miratojë ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 500.00 €, për mbështetjen e aktiviteteve dhe funksionimit të saj.

Kjo mbështetje paraqet një shprehje të respektit institucional dhe të përkushtimit të Komunës së Mitrovicës ndaj organizatave që kontribuojnë në ruajtjen dhe promovimin e vlerave historike dhe shoqërore.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica



DATË/A:	06.07.2026
REFERENCË/A	
PËR/ZA/TO:	z. Safet Kamberi – Kryesues i Kuvendit ne Komunën e Mitrovicës se Jugut
CC:	z. Gazmend Gjoshaj – Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
PËRMES/ PREKO/ THROUGH:	z. Faton Peci - Kryetar i Komunës se Mitrovicës Jugore
NGA/OD/FROM:	z. Ramadan Beshiri - Drejtor i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale
TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT:	Propozim vendim për mbështetje financiare në shumën 500.00 euro për Shoqatën e të Verbërve në Mitrovicë

Të nderuar,

Shoqata e të Verbërve në Mitrovicë është një organizatë me interes publik, e cila përfaqëson dhe mbron të drejtat e personave me dëmtim të shikimit, duke kontribuar në përfshirjen sociale, fuqizimin dhe mbështetjen e kësaj kategorie të qytetarëve.


Duke marrë parasysh aktivitetet dhe rolin e rëndësishëm që kjo shoqatë ushtron në komunitet, propozohet që Kuvendi Komunal të miratojë ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 500.00 €, me qëllim të mbështetjes së veprimtarisë dhe funksionimit të saj. Mbështetja e kësaj shoqate paraqet përkushtimin e Komunës së Mitrovicës për avancimin e mirëqenies sociale dhe përkrahjen e kategorive të cënueshme të shoqërisë.

Të bashkangjitur me propozim vendimin e keni edhe kërkesën nga përfaqesuesi i Shoqatës së të Verbërve në Mitrovicë, z. Bekim Ferati.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica



DATE/A:	06.07.2026
REFERENCË/A	
PËR/ZA/TO:	z. Safet Kamberi – Kryesues i Kuvendit ne Komunën e Mitrovicës se Jugut
CC:	z. Gazmend Gjoshaj – Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
PËRMES/ PREKO/ THROUGH:	z. Faton Peci - Kryetar i Komunës se Mitrovicës Jugore
NGA/OD/FROM:	z. Ramadan Beshiri - Drejtor i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale
TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT:	Propozim vendim për mbështetje financiare në shumë prej 500.00 € për Shoqatën e të Shurdhve në Mitrovicë

Të nderuar,

Shoqata e të Shurdhve në Mitrovicë luan një rol të rëndësishëm në përfaqësimin, mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të personave me dëmtim të dëgjimit, duke kontribuar në përfshirjen e tyre të barabartë në jetën shoqërore dhe institucionale.

Duke marrë parasysh rëndësinë e veprimtarisë së kësaj shoqate dhe nevojën për mbështetje institucionale të kategorive të cenueshme, propozohet që Kuvendi Komunal të miratojë ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 500.00 € për mbështetjen e aktiviteteve dhe funksionimit të saj.

Përkrahja e kësaj shoqate dëshmon angazhimin e Komunës së Mitrovicës për ndërtimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse dhe të barabartë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica

DATË/A:	16.07.2026
REFERENCË/A	02-400/04-0041327/h6
PËR/ZA/TO:	z. Safet Kamberi – Kryesues i Kuvendit ne Komunën e Mitrovicës se Jugut
CC:	z. Gazmend Gjoshaj – Drejtor i Financave
PËRMES/ PREKO/ THROUGH:	z. Faton Peci - Kryetar i Komunës se Mitrovicës Jugore <i>Pën [Signature]</i>
NGA/OD/FROM:	z. Ramadan Beshiri - Drejtor i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale
TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT:	Propozim vendim për mbështetje financiare në shumën 250.00 në muaj për Tetë (8) familje nga Bajri.

Të nderuar,

Arsyetim për mbështetje financiare të familjeve të prekura nga rrëshqitja e dheut në lagjen Bajr.

Pas vlerësimit të gjendjes në terren, është konstatuar se tetë (8) familje në lagjen Bajr po jetojnë në kushte të rënda si pasojë e rrëshqitjes së dheut, e cila ka rrezikuar sigurinë e pronave të tyre dhe ka pamundësuar jetesën në kushte normale. Për shkak të rrezikut të vazhdueshëm për jetën dhe pronën, këto familje janë detyruar të largohen nga shtëpitë e tyre dhe të sigurojnë strehim me qira.

Duke pasur parasysh gjendjen e tyre të rënduar sociale dhe ekonomike, si dhe nevojën për të garantuar strehim të sigurt dhe dinjitoz deri në krijimin e kushteve për zgjidhje të qëndrueshme, konsiderohet e domosdoshme mbështetja institucionale për mbulimin e shpenzimeve të qirasë.

Propozohet që secila prej tetë (8) familjeve të përfitojë mbështetje financiare në vlerë prej **250.00 euro në muaj**, për një periudhë prej **12 (dymbëdhjetë) muajsh**, me qëllim të mbulimit të shpenzimeve të qirasë. Kjo përkrahje do të mundësojë strehim të përkohshëm dhe të sigurt për familjet e prekura, duke zbutur pasojat sociale dhe ekonomike të shkaktuara nga kjo fatkeqësi.

Mbështetja e propozuar është një masë e domosdoshme humanitare dhe sociale, e cila synon mbrojtjen e dinjitetit, mirëqenies dhe sigurisë së qytetarëve të prekur, në përputhje me përgjegjësitë e Komunës për përkujdesje ndaj familjeve në nevojë dhe menaxhimin e rasteve emergjente.



02-400/04-0040498/26
140726

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica

DATË/A:	06.07.2026
REFERENCË/A	
PËR/ZA/TO:	z. Safet Kamberi – Kryesues i Kuvendit ne Komunën e Mitrovicës se Jugut
CC:	z. Gazmend Gjoshaj – Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
PËRMES/ PREKO/ THROUGH:	z. Faton Peci - Kryetar i Komunës së Mitrovicës Jugore
NGA/OD/FROM:	z. Ramadan Beshiri - Drejtor i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale
TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT:	Propozim vendim për mbështetjen financiare në shumë prej 250.00 € për viktimat e dhunës gjatë vitit 2026 në Komunën e Mitrovicës së Jugut

Të nderuar,

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, nënparagrafi d) dhe nenin 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, dispozitat përkatëse të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen dhe përkrahjen e kategorive të cënueshme, si dhe Statutin e Komunës së Mitrovicës.

Po ashtu duke marrë parasysh nevojën për mbështetje institucionale të viktimave të dhunës në Komunën e Mitrovicës, Drejtoria e Mirëqenies Sociale, me iniciimin e anëtares së Kuvendit Komunal, **znj. Erseka Barani**, propozon ndarjen e mbështetjes financiare në shumë prej **250.00 €** për viktimat e dhunës.

Kjo mbështetje synon të ofrojë ndihmë emergjente dhe sociale për personat që kanë përjetuar dhunë, duke kontribuar në përballimin e nevojave bazike dhe në procesin e tyre të stabilizimit dhe riintegrit social.

Shuma e propozuar prej **250.00 €** arsyetohet dhe vërtetohet mbi bazën e të dhënave të ofruara nga **Qendra për Punë Sociale në Mitrovicë**, e cila, në kuadër të mandatit të saj ligjor, identifikon dhe trajton rastet e viktimave të dhunës. Përkrahja bëhet për qdo viktimë të dhunës që është evidentuar në të dhënat zyrtare në QPS (**Qendra për Punë Sociale në Mitrovicë**) dhe në bashkëpunimin me QMGF “Raba Voca”.

Përkrahja financiare e propozuar paraqet një masë konkrete të solidaritetit institucional dhe mbështetjes së kategorive më të cënueshme të shoqërisë, në përputhje me përgjegjësitë sociale të Komunës së Mitrovicës.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica



02-400/24-0040499/26
14 07 26

DATË/A:	06.07.2026
REFERENCË/A	
PËR/ZA/TO:	z. Safet Kamberi – Kryesues i Kuvendit ne Komunën e Mitrovicës se Jugut
CC:	z. Gazmend Gjoshaj – Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
PËRMES/ PREKO/ THROUGH:	z. Faton Peci - Kryetar i Komunës se Mitrovicës Jugore
NGA/OD/FROM:	z. Ramadan Beshiri – Drejtor i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale
TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT:	Propozim vendim për mbështetjen financiare 500.00 euro për mbulimin e qirasë për Qendrën për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve “Raba Voca” në Mitrovicë

Të nderuar,

Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve “Raba Voca” është një institucion me rëndësi të veçantë sociale, i cili ofron strehim, mbrojtje, rehabilitim dhe mbështetje për gratë dhe fëmijët viktimë të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

Bazuar në kërkesën e ripërsëritur të paraqitur nga znj. Fidane Hyseni, qendra aktualisht po përballet me vështirësi financiare dhe detyrime të papaguara, të cilat rrezikojnë funksionimin dhe vazhdimësinë e shërbimeve të saj. Objekti i ri i Shtëpisë së sigurtë është në përfundim e sipër, prandaj kjo mbështetje nuk do jetë e nevojshme në të ardhmen sepse do kemi infrastrukturen e plotë sociale për këtë mekanizëm.

Vetëm gjatë vitit 2026, kjo qendër ka ofruar strehim, mbrojtje dhe rehabilitim për **16 viktimë të dhunës**, duke dëshmuar rolin e saj të pazëvendësueshëm në sistemin lokal të

mbrojtjes sociale. Duke marrë parasysh rëndësinë e shërbimeve që ofron kjo qendër, si dhe nevojën për të garantuar vazhdimësinë e funksionimit të saj, propozohet ndarja e mjeteve financiare në vlerë prej **500.00 €** për mbulimin e shpenzimeve të qirasë.

Ndarja e këtyre mjeteve përfaqëson një mbështetje të domosdoshme institucionale për mbrojtjen e kategorive më të cenueshme dhe për garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve sociale në Komunën e Mitrovicës.

Të bashkangjitur me propozim vendimin e keni edhe kërkesën e znj. Fidane Hyseni, Drejtoreshë e QMGF “Raba Voca”.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica



DATË/A:	06.07.2026
REFERENCË/A	
PËR/ZA/TO:	z. Safet Kamberi – Kryesues i Kuvendit ne Komunën e Mitrovicës se Jugut
CC:	z. Gazmend Gjoshaj – Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
PËRMES/ PREKO/ THROUGH:	z. Faton Peci - Kryetar i Komunës se Mitrovicës Jugore
NGA/OD/FROM:	z. Ramadan Beshiri – Drejtor i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale
TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT:	Për përkrahjen financiare 500.00 Euro për ofrimin e shërbimeve sociale dhe rehabilituese të OJQ-së “Down Syndrome Kosova” – Dega në Mitrovicë

Të nderuar,

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (d), nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë e Komunës në fushën e mirëqenies sociale dhe ofrimit të shërbimeve sociale, Po ju drejtohem me propozim vendim për përkrahje financiare në vlerë prej **500.00 (pesëqind euro)** për OJQ-në **“Down Syndrome Kosova” – Dega në Mitrovicë**, për mbulimin e shërbimeve të logopedisë për fëmijët përfitues.

Të bashkangjitura gjeni edhe arsyetim zyrtar nga z. Xhenis Beqiri nga Down Syndrome Kosova, dega në Mitrovicë.

Mjetet financiare të parapara do të përdoren për ofrimin e shërbimeve sociale dhe rehabilituese për **28 fëmijë të moshës 0–14 vjeç**, sipas planit vjetor të shërbimeve, si në vijim:

- **28 fëmijë** do t'i nënshtrohen vlerësimit multidisiplinar dhe do të pajisen me raport vlerësues profesional;
- **6 fëmijë** të moshës **0–2 vjeç** do të përfitojnë ndërhyrje të hershme përmes planeve individuale të zbatuara në mjedisin familjar;
- **22 fëmijë** do të përfitojnë shërbime individuale të logopedisë në Qendrën e Down Syndrome Kosova në Mitrovicë, me bazë në komunitet, përmes seancave individuale prej **45 minutash**, sipas Planit Individual të Trajtimit.

ARSYETIM


OJQ-ja “Down Syndrome Kosova” – Dega në Mitrovicë, ofron shërbime të specializuara sociale, rehabilituese dhe terapeutike për fëmijët me sindromën Down dhe familjet e tyre. Përmes mbështetjes së ofrimit të shërbimeve të logopedisë, synohet përmirësimi i komunikimit, zhvillimit gjuhësor dhe integritetit social të fëmijëve përfitues.

Duke marrë parasysh rëndësinë e këtyre shërbimeve për mirëqenien, zhvillimin dhe përfshirjen sociale të fëmijëve, propozohet miratimi i këtij vendimi.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South



RAPORT GJASHTËMUJOR I PUNËS SË DREJTORISË PËR EKONOMI, ZHVILLIM, TURIZËM DHE INTEGRIME EVROPIANE (Janar 2026 - Qershor 2026)

Mitrovicë, 2026

Fjala hyrëse

Në programin tonë qeverisës 2025 - 2029, prioriteti ynë është zhvillimi ekonomik lokal përmes fuqizimit të bizneseve dhe zhvillimit të turizmit, e që si qëllim kryesor është punësimi. Që nga momenti i marrjes së mandatit, kemi parë të nevojshme fuqizimin dhe rritjen e zhvillimit ekonomik. Turizmi është vendosur si një fushë me potencial të madh në Mitrovicë, me theks të veçant Shala e Bajgorës, zonë e lënë pas dore.

Që nga fillimi i marrjes së mandatit, Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm është angazhuar në krijimin e një ambienti të favorshëm për fuqizimin bizneseve dhe forcimin e mekanizmave të zhvillimit ekonomik lokal, ashtu që kemi vizituar shumë biznese dhe zona të cilat konsiderojmë që kanë potencial të madh në zhvillim të turizmit lokal.

Prioritet kryesor për këtë vit dhe vitet në vazhdim do të jetë:

1. Rritja e buxhetit të drejtorisë i cili do të krijoj mundësi në zhvillimin ekonomik dhe zhvillimin e turizmit lokal;
2. Fuqizimi i bizneseve, përmes përkrahjes me theks të veçant të bizneseve fillestare, por edhe të atyre ekzistuese;
3. Fuqizimi dhe promovimi i turizmit lokal;
4. Krijimin e kushteve të favorshme për biznese në zonat ekonomike;

Hyrje

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritet Evropian, gjatë periudhës janar–qershor 2026 ka zhvilluar një sërë aktivitete të rëndësishme që kanë kontribuar në avancimin e zhvillimit ekonomik lokal, përmirësimin e menaxhimit të të hyrave komunale, krijimin e mundësive për punësim, si dhe promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit.

Gjatë kësaj periudhe, Drejtoria ka qenë e fokusuar në realizimin e objektivave strategjike që synojnë përmirësimin e mirëqenies ekonomike të qytetarëve, mbështetjen e kategorive të ndryshme të shoqërisë, forcimin e bashkëpunimit me institucionet qendrore dhe partnerët ndërkombëtarë, si dhe krijimin e kushteve për investime dhe zhvillim afatgjatë.

Aktivitetet e realizuara dëshmojnë për një angazhim të vazhdueshëm tonin, në realizimin e projekteve zhvillimore dhe në administrimin efikas të përgjegjësisë që i takojnë kësaj drejtorie.

Gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti, në bashkëpunim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), kemi filluar dhe jemi në proces të hartimit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Mitrovicës. Kjo strategji është duke u përgatitur në përputhje dhe harmonizim me Strategjinë Nacionale për Zhvillim 2026–2036, me qëllim krijimin e një kornize strategjike për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, rritjen e investimeve, mbështetjen e ndërmarrësisë dhe përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve.

Draft-strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Mitrovicës synojmë ta dërgojmë për miratim në kuvendin komunal gjatë këtij viti.

Menaxhimi i të hyrave përmes taksës - komunale

Një ndër prioritetet e Drejtorisë gjatë kësaj periudhe ka qenë administrimi dhe inkasimi i të hyrave komunale nga taksat lokale.

Për periudhën janar–dhjetor 2026 është planifikuar realizimi i të hyrave nga taksa komunale në shumën prej **40,000.00 euro**, ndërsa falë angazhimit të stafit të kësaj drejtorie është arritur inkasimi në shumën prej **49,400.00 euro**.

Ky rezultat paraqet realizim mbi planifikimin e paraparë, me një tejkalim prej **9,400.00 euro**, respektivisht rreth **23.5 %** më shumë se objektivi i planifikuar deri në dhjetor të vitit 2026.

Ky sukses është rezultat i monitorimit të vazhdueshëm të obligimeve tatimore, komunikimit me subjektet ekonomike dhe ndërmarrjes së veprimeve administrative për rritjen e disiplinës fiskale dhe përmirësimin e performancës në inkasimin e të hyrave komunale.

Në kuadër të kësaj, gjatë gjashtëmujorit të parë, Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritet Evropian ka realizuar identifikimin e të gjitha bizneseve që nuk kanë përmbushur obligimet e tyre lidhur me pagesën e taksës komunale për vitet paraprake e që kanë qenë të obliguar sipas Rregullores komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha Komunale. Bazuar në të dhënat e evidentuara, vlera e përgjithshme e borxheve të papaguara arrin mbi **150,000.00 euro**.

Me qëllim të rritjes së nivelit të inkasimit të të hyrave komunale dhe sigurimit të zbatimit të legjislacionit në fuqi, gjatë gjysmës së dytë të vitit Drejtoria do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për të gjitha bizneset që, edhe pas njoftimeve dhe afateve të përcaktuara ligjore, nuk i përmbushin obligimet e tyre për pagesën e taksës komunale, lëndët do të procedohen të përmbaruesi privat për iniciimin e procedurës përmbartimore. Kjo masë synon rritjen e disiplinës financiare, trajtimin e barabartë të të gjithë taksa-paguesve dhe përmirësimin e inkasimit të të hyrave vetanake të Komunës së Mitrovicës.

Poashtu kemi kanqësinë të ju njoftojmë që gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti, Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritet Evropian ka qenë dhe është pjesë aktive për plotësim-ndryshimin e Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Gjoha Komunale, duke dhënë propozime dhe rekomandime konkrete me qëllim të administrimit më efikas të taksës komunale të biznesit.

Propozimet e Drejtorisë janë fokusuar në përfshirjen e bizneseve të mëdha në sistemin e pagesës së taksës komunale, pasi bazuar në rregulloren aktuale e cila në fuqi, një numër i konsiderueshëm i bizneseve me kapacitete të mëdha ekonomike nuk janë të përfshira në obligimin për pagesën e kësaj takse. Ky trajtim konsiderojmë që ka krijuar pabarazi ndërmjet subjekteve ekonomike, duke bërë që një pjesë e bizneseve të bartin barrën e taksa-paguesëve, ndërsa të tjerat të përjashtohen nga ky obligim.

Përmes këtyre ndryshimeve synohet krijimi i një sistemi më të drejtë dhe më të barabartë për taksa-paguesit, zgjerimi i bazës së taksa-paguesve, rritja e të hyrave nga taksa komunale, nga plaifikimi prej 40,000.00 eurove në vit, në min. 200,000.00 euro në vit.

Programi i praktikës profesionale për personat me aftësi të kufizuara

Në kuadër të politikave komunale për promovimin e barazisë në mundësi dhe përfshirjen sociale, Drejtoria ka realizuar programin e praktikës profesionale me pagesë për 20 (njëzet) personat me aftësi të kufizuara.

Përmes këtij programi janë krijuar mundësi konkrete për angazhimin profesional të kësaj kategorie të qytetarëve, duke u ofruar atyre përvojë praktike në institucionet komunale, dhe biznese me mundësi për zhvillimin e aftësive profesionale.



Programi synon jo vetëm përfitimin e përvojës së punës, por edhe fuqizimin e pozitës së personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës, promovimin e gjithëpërfshirjes dhe zbatimin e politikave të barazisë në punësim.



Ky aktivitet paraqet një hap të rëndësishëm drejt krijimit të një administrate dhe shoqërie më gjithëpërfshirëse.



Gjatë periudhës gjashtëmujore është realizuar ndërtimi dhe funksionalizimi i liftit në objektin e Komunës së Mitrovicës, projekt i iniciuar nga Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritet Evropian. Ky projekt është realizuar në bashkëfinancim me organizatën PREDA dhe ka për qëllim përmirësimin e qasjes në objektin komunal, veçanërisht për personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit dhe qytetarët me nevoja të veçanta, duke kontribuar në rritjen e cilësisë së shërbimeve komunale.



Programi i praktikës me pagesë për 100 të rinj

Gjatë periudhës raportuese është realizuar një nga programet më të rëndësishme të punësimit, përmes angazhimit të **100 praktikantëve me pagesë**, i cili është zbatuar në bashkëfinancim me Agjencionin e Punësimit, UNICEF KOSOVO PROGRAM dhe Odes Ekonomike Gjermano-Kosovare.

Ky program ka pasur për qëllim ofrimin e mundësive konkrete për të rinjtë që të fitojnë përvojë profesionale, të zhvillojnë aftësitë e tyre praktike dhe të rrisin mundësitë për punësim në të ardhmen.

Përfituesit janë sistemuar në institucione të ndryshme komunale në përputhje me profilin e tyre profesional, duke kontribuar njëkohësisht në rritjen e kapaciteteve institucionale dhe në zhvillimin profesional të të rinjve.



Ky program përbën një investim të rëndësishëm në resurse njerëzore dhe në përgatitjen e kuadrove të reja profesionale.

Hartimi i Master Planit për Zhvillimin e Turizmit

Në kuadër të prioriteteve strategjike të Drejtorisë është iniciuar procesi për hartimin e **Master Planit për Zhvillimin e Turizmit**, i cili është duke u realizuar përmes një modeli bashkëfinancimi, ku **50% e mjeteve financohen nga Komuna**, ndërsa **50% nga një organizatë ndërkombëtare partnere** siç është **SWISS CONTACT**.

Ky projekt paraqet një nga dokumentet më të rëndësishme strategjike për sektorin e turizmit, pasi do të përcaktojë drejtimet kryesore të zhvillimit turistik të komunës për vitet në vijim.

Master Plani do të mundësojë identifikimin e potencialeve turistike, evidentimin e aseteve natyrore, kulturore dhe historike, përcaktimin e zonave prioritare për investime, si dhe hartimin e politikave që synojnë zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit. Po ashtu, ky dokument do të shërbejë si bazë për aplikimin në fondet e donatorëve dhe programeve ndërkombëtare, duke rritur mundësinë e tërheqjes së investimeve dhe zhvillimit të ofertës turistike të komunës.

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritet Evropian, në cilësinë e bashkëorganizatorit, ka marrë pjesë në organizimin dhe realizimin e **Panairit të Produkteve Turistike dhe Tradicionale të Shalës së Bajgorës**, me qëllim të promovimit të potencialit turistik, kulturor dhe ekonomik të kësaj zone.



Panairi mbledhi prodhues lokalë, artizanë, përfaqësues të bizneseve dhe vizitorë të shumtë, duke ofruar një platformë për promovimin e produkteve tradicionale, artizanatit, gastronomisë dhe vlerave turistike të rajonit. Gjatë aktivitetit u promovuan gjithashtu mundësitë për zhvillimin e turizmit lokal dhe u inkurajua bashkëpunimi ndërmjet institucioneve dhe akterëve lokal.



Ky aktivitet kontribuoi në promovimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të Shalës së Bajgorës, si dhe në mbështetjen e zhvillimit ekonomik lokal përmes promovimit të produkteve dhe shërbimeve vendore.



Bashkëpunimi institucional

Gjatë kësaj periudhe Drejtoria ka vazhduar bashkëpunimin me institucionet e nivelit qendror, organizatat ndërkombëtare dhe partnerët zhvillimorë, me qëllim të sigurimit të mbështetjes financiare dhe teknike për realizimin e projekteve me interes publik.

Ky bashkëpunim ka ndikuar në krijimin e mundësive të reja për zhvillimin ekonomik lokal, përmirësimin e kapaciteteve institucionale dhe realizimin e projekteve strategjike në interes të qytetarëve.

Nënshkrimi i Marrëveshjes për Parkun Industrial në Mitrovicë

Gjatë periudhës janar– qershor 2026, është arritur një nga rezultatet më të rëndësishme në fushën e zhvillimit ekonomik, përkatësisht është nënshkruar Marrëveshja për financimin dhe zhvillimin e Eko-Parkun Industrial në Zonën Industriale në Frashër ndërmjet Komunës së Mitrovicës dhe Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në vlerë prej **1 milion euro**.



Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt krijimit të kushteve më të favorshme për zhvillimin ekonomik lokal dhe përmirësimin e infrastrukturës ekonomike në territorin e komunës. Përmes këtij investimi do të krijohen parakushtet e nevojshme për funksionalizimin dhe zhvillimin e Eko-Parkun Industrial në Zonën Industriale, duke ofruar hapësira të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve prodhuese, përpunuese dhe shërbyese.



Ky projekt pritet të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e investimeve vendore dhe të huaja, fuqizimin e sektorit privat, krijimin e vendeve të reja të punës dhe rritjen e konkurrencës së bizneseve lokale.

Gjithashtu, funksionalizimi i Eko-Parkun Industrial në Zonën Industriale do të kontribuojë në përmirësimin e klimës së të bërit biznes dhe në krijimin e mundësive të reja për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik në Komunën e Mitrovicës.



Realizimi i kësaj marrëveshjeje është rezultat i bashkëpunimit institucional ndërmjet Komunës së Mitrovicës dhe Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, duke dëshmuar angazhimin e përbashkët për avancimin e politikave zhvillimore dhe krijimin e kushteve më të mira për investime dhe zhvillim ekonomik afatgjatë.

Raport nga zyra për regjistrim të bizneseve

Po ashtu kemi marrë edhe raporti nga zyrja për regjistrimin e bizneseve gjatë kësaj periudhe ku janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

• Regjistrim i biznesit	247
• Ndryshime në biznes	150
• Shuarje të biznesit	34
• Gjithësejt:	431

Koordinimi me MAPL lidhur me raportin e performancës komunale - Është zhvilluar koordinim i vazhdueshëm me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) në lidhje me raportin e performancës komunale. Gjatë kësaj periudhe janë trajtuar çështje të rëndësishme që ndërlidhen me përmbushjen e indikatorëve të performancës, si dhe janë ndërmarrë veprime për përditësimin dhe harmonizimin e të dhënave sipas kërkesave dhe standardeve të përcaktuara.


Gjatë kësaj periudhe nuk janë evidentuar sfida të theksuara që do të ndikonin në mbarëvajtjen e aktiviteteve. Megjithatë, mbetet e rëndësishme vazhdimi i angazhimit për përmirësimin e proceseve dhe rritjen e efikasitetit në punë.

Përfundim

Bazuar në aktivitetet e realizuara gjatë periudhës Janar– Qershor 2026, Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritet Evropian ka realizuar me sukses një pjesë të konsiderueshme të objektivave të parapara në planin vjetor të punës.

Rezultatet e arritura në rritjen e të hyrave komunale, zbatimin e programeve të punësimit, mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara, angazhimin e të rinjve në praktikë profesionale dhe avancimin e projektit për hartimin e Master Planit të Turizmit dëshmojnë për përkushtimin e Drejtorisë në realizimin e misionit të saj institucional.

Drejtorja mbetet e angazhuar që edhe gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit të vazhdojë me realizimin e projekteve zhvillimore, rritjen e efikasitetit në administrimin e kompetencave të saj, forcimin e bashkëpunimit me partnerët institucionalë dhe ndërkombëtarë, si dhe krijimin e mundësive të reja për zhvillimin ekonomik, punësimin dhe promovimin e potencialit turistik të komunës.

**Drejtor për Ekonomi, Zhvillim
Turizëm dhe Integritet Evropian**

Z. Gani Rrustemi

